



NDËRMARRJET SHOQËRORE DHE TRANSFORMIMI/PRIVATIZIMI I TYRE

Draft i Raportit Hulumtues

**Raport i përgatitur në bashkëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrjet
Private (CIPE) dhe e mbështetur nga Agjensia e SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtarë
(USAID)**

Prishtinë, 8 Mars, 2001

Përmbajtja

Përmbledhje e përgjithshme e rezultateve nga anketa, analiza dhe rekomandime

Rezultatet Kryesore nga Anketa	4
Përmbledhje e Çështjeve nga e Kaluara	5
Rekomandimet	6

PJESA I HYRJE

Objektivat	7
Përmbajtja e Raportit	8
Metodologjia e Hulumtimit	9

PJESA II REZULTATET E ANKETËS

I. Niveli i Aktivitetit Ekonomik të Ndërmarrjeve Shoqërore	12
1. Niveli i Riaktivizimit	12
2. Shfrytëzimi i Kapaciteteve	13

II. Rezultatet Financiare	15
1. Vëllimi i Shitjes	15
2. Shpenzimet	15
3. Të Ardhurat Personale	15
4. Fitimi/Humbja	16
5. Mjetet e Xhiors	16
6. Kërkesat dhe Obligimet	17

III. Problematika e Tregut dhe Eksportit	18
--	----

IV. Personeli	20
1. Shkalla e Aktivizimit dhe Struktura Kualifikuese	20
2. Stafi Udhëheqës	21
3. Moshë e të Punësuarve	22

V. Kapitali Fiks	23
------------------------	----

VI. Dëmet e Luftës	25
--------------------------	----

VII. Investimet	26
1. Aktiviteti i Gjërëtanishëm Investiv	26
2. Investimet e Nevojshme për Konsolidimin e Prodhimit	26
3. Burimet e Pritura të Investimeve	27

PJESA III TRANSFORMIMI I NDËRMARRJEVE SHOQËRORE NË KOSOVË

(1) Aktivitetet Lidhur me Transformimin e Ndërmarrjeve Shoqërore	29
(2) Qëndrimet e Komunitetit të Biznesit	33
(3) Opcionet dhe Kriteret e Privatizimit	35

ANEKSET

Aneksi I – Statistikat	38
Aneksi II – Pyetësi Anketues	43

Botues © RIINVEST, Mars, 2001.

Instituti për Hulumtime Zhvillimore RIINVEST

Sheshi "Nënë Tereza" nr. 7/III

38 000 Prishtinë, Kosovë

Tel/fax: +381 38 549 320

E-mail: riinvestconf@hotmail.com

Të gjitha të drejtat mbrohen.

Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të ribotohet jashtë të drejtave të autorit. Rezultatet, interpretimet, dhe konkluzionet e nxjerra në këtë publikim mund të shfrytëzohen vetëm nëse citohet burimi i referencës në punën tuaj.

NDËRMARRJET SHOQËRORE DHE TRANSFORMIMI/PRIVATIZIMI I TYRE

PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME E REZULTATEVE NGA ANKETA, ANALIZA DHE REKOMANDIME

REZULTATET KRYESORE NGA ANKETA

- Pjesa dërmuese (86 %) e ndërmarrjeve të anketuara janë aktive (në vitin 1999 aktive ishin 55-60 %), por shfrytëzojnë vetëm 30 % të kapaciteteve të veta. Nivel mbi mesatar të shfrytëzimit të kapaciteteve kanë realizuar: shërbimet (57.5 %), transporti (54.1 %), prodhimi i materialit ndërtimor (51.1 %), tregëtia (43.7 %) dhe ndërtimtaria (40.6 %).
- Aktiviteti ekonomik në vitin 2000 në krahasim me vitin 1999 është dyfishuar. Prodhimtaria e këtyre ndërmarrjeve kryesisht (99 %) është e orientuar në tregun e mbrendshëm.
- Pengesat për rritjen e aktivitetit ekonomik janë kryesisht: mungesa e kapitalit financiar, teknologjia jokonkurrese, dëmtimet nga menaxhimi i dhunëshëm dhe lufta dhe dilemat e UNMIK-ut rreth karakterit të pronës shoqërore;
- Në këto ndërmarrje janë të evidentuar 42.581 punëtorë nga të cilët vetëm 24.662 (58 %) janë aktiv, 16.000 janë në pushim pa pagesë dhe 3.300 marrin paga në shtëpi. Paga mesatare mujore në këto ndër-marrje është rreth 200 DM. Mosha mesatare e të punësuarëve është e lartë (40-55 vjet) dhe paraqet vështirësi për përvetësimin dhe zhvillimin e shkathtësive të biznesit dhe prodhimitarisë bashkëkohore.
- Kapitali fiks i këtyre ndërmarrjeve vlerësohet në 3.5 mld.DM, ndërsa shkalla e amortizimit vlerësohet në 55 -60 %. Në 43 % të ndërmarrjeve të anketuara shkalla e amortizimit është mbi 60 %. Sipas sektorëve shkalla më e lartë e amortizimit të paisjeve teknologjike është në xehëtari (70.0 %), përpunimi i drurit (60.0 %), sektori metalpërpunues dhe paisjet elektrike (60.0 %) dhe bujqësia (70.0 %). Ky nivel i lartë i amortizimit është signal i çartë se këto ndërmarrje kanë nevojë për një regjenerim teknologjik;
- Obligimet e tërësishme të ndërmarrjeve shoqërore janë dyfish më të mëdha se sa kërkesat. Mesatarja e obligimeve për një ndërmarrje është 1 milion DEM.
- Investimet e deritanishme të NSH-ve janë shumë më të vogla se sa nevojat reale për investime. Humbjet e mëdha në këto ndërmarrje si rezultat i konfliktit ushtarak vlerësohen në 1.3 miliard DEM. Niveli i amortizimit, humbjet dhe dëmet nga lufta, krijojnë nevojën për joshjen e konsiderueshme të investimeve. Vetëm 38 milion DEM janë investuar nga ana e këtyre ndërmarrjeve në periudhën e pas luftës deri në Shtator të vitit 2000, ndërsa nevojat reale të vlerësuara nga menaxhmenti i këtyre ndërmarrjeve, tejkalojnë shumën 785 milion DEM.

- Shumica e ndërmarrjeve të anketuara (83 %) kanë manifestuar qendrim pozitiv për kyçje në procesin e privatizimit dhe këtë e konsiderojnë metodë themelore të transformimit për konsolidimin afatgjatë të aktivitetit ekonomik. Vetëm 10 % të ndërmarrjeve të anketuara janë kundër procesit të privatizimit.
- Ndërmarrësit privat gjithashtu e mbështesin privatizimin e menjëhershëm (78% e të anketuarve) dhe shfaqin gatishmërinë e tyre për të marrë pjesë përmes blerjes së aksioneve dhe përmes aktivteteve tjera.

PËRMBLEDHJE E ÇËSHTJEVE NGA E KALUARA

- Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është e orientuar në ndërtimin e “autonomisë substanciale dhe vetëqeverisjes” në Kosovë përpara se të definohet statusi përfundimtarë i saj. Ndërtimi I institucioneve të ekonomisë së tregut përfshinë privatizimin si faktorë kyç në procesin e reformave dhe zhvillimin e një ekonomie efikase. Kjo është shumë e rëndësishme për suksesin dhe efektin e investimeve që bashkësia ndërkombëtare është duke e bërë në Kosovë. Duke pasur parasysh se privatizimi është faktorë kyç për qeverisjen efektive me pasuri dhe resurse ekonomike, ne konsiderojmë se realizimi i këtij procesi është në kompetenca dhe përgjegjësitë e autiriteteve të UNMIK-ut, pasi që Rezoluta 1244 nuk e kudërshton privatizimin.
- Autorizimet ligjore dhe kushtetuese në lidhje me qeverisjen e pronës shoqërore në Kosovë ishin të njëjta me ato të njëjsteve tjera fedarale të ish-Jugosllavisë.
- Prona shoqërore për nga natyra e saj nuk ishte pengesë në procesin e privatizimit në njësitë e mëparshme të Jugosllavisë si Kroacia, Slovenia, Maqedonia, dhe Bosnja e Hercegovina. Bile edhe Mali i Zi është duke e zbatuar programin e tij të privatizimit në mënyrë të pavarur nga Serbia, edhe pse ai është pjesë e “RFJ”.
- Ligjet e nxjerra nga Serbia pas vitit 1989 kanë qenë jolegale dhe rezultat i dhunës në të gjitha fushat, kështu që ajo gjendje nuk mund të merret si legale. Këto ligje kanë qenë diskriminuese jo vetëm në zbatimin e tyre në Kosovë por edhe në procedurën e nxjerrjes duke pasë parasysh se Shqiptarët nuk morën pjesë në nxjerrjen e tyre por ato iu imponuan me dhunë Kosovës dhe popullit të sajë. Pretendimet dhe kontestet eventuale lidhur me pronsinë duhen të zgjidhen në gjykata të regullta vendore si dhe ato ndërkombëtare. Procesi i privatizimit duhet të shpejtohet sepse çdo vonim në implementimin e tij do të ketë konsekuenca sociale si dhe në përkeqësimin e situatës në ndërmarrjet shoqërore.
- Duke u bazuar në rezultatet e anketës, komuniteti i biznesit dhe shoqëria Kosovare shprehin gatishmërinë e tyre për ta përkrahur procesin e privatizimit.

REKOMANDIMET

- Duke filluar nga tri kritere themelore: (1) ndikimi në procesin e reformave dhe ndërtimi i ekonomisë së tregut; (2) efektiviteti dhe efikasiteti; (3) joshja e investimeve të drejtpërdrejta private të vendit dhe të huaja – RIINVEST-i angazhohet për shpejtimin e procesit të privatizimit duke u bazuar në metodat e përparuara që janë implementuar në vendet e tranzicionit. Bazuar në këto kritere, privatizimi i ka përparësitë e veta mbi komercializimin dhe shëndrrimin e NSH-ve në shoqëri aksionare ku shumica e aksioneve do t'i takonin të punësuarve.
- Dhënia me qira konsiderohet si përjashtim nga procesi i privatizimit dhe mund të aplikohet vetëm në rastet kur privatizimi nuk është i suksesshëm, dhe për një periudhë më të shkurtë kohore (1 – 3 vite) se sa ajo që aplikohet tani.
- Dhënja me qëra duhet të konsiderohet si një përjashtim në rastin e privatizimit edhe atë kur për privatizim nuk ka sukses. Letra e DTI (Departamenti për Industri dhe Tregti) e datës 13 dhjetor 2000 të cilën ia drejtoi shtyllës së IV të UNMIKUT e që ka të bëjë me transformimin e ndërmarrjeve në pronësi shoqërore në shoqëri aksionare mund të mbështetet në parim, por duke tentuar që të eliminohen dobësitë që mundë të ketë për angazhimin e investitorve serioz dhe sidomos investitorve të jashtëm dhe menaxhimin e kompanive.
- RIINVEST-i e përkrah aktivitetin e DTI-së lidhur me përshpejtimin në punimin e drafteve dhe aprovimin e ligjeve me qëllim të rumbullaksimit të kornizës ligjore të procesit të privatizimit si dhe ligjeve tjera (nxjerrja e ligjeve komerciale/ekonomike). Është e qartë se privatizimi duhet të kryhet përmes Ligjit mbi Privatizimin, i cili do t'i parasheh edhe format e tjera të transformimit të pronës, të cilat janë shumë më të avancuara se sa dhënja e ndërmarrjes me qëra (kontratat mbi dhënje me qira).
- Përvojat nga vendet tjera në tranzicion sugjerojnë se për reforma dhe privatizim të suksesshëm, është e nevojshme një Strategji e Qëndrueshme e Privatizimit. Kjo strategji duhet të përfshijë metodat dhe modelet përparuara të privatizimit, aranzhmanet institucionale dhe aspektet ligjore, menaxhmentin efikas të privatizimit dhe transparencën si parakusht i privatizimit të drejtë.
- Dilemat dhe kontestet e mundshme mbi pronësinë duhet të zgjidhen në gjykatat e vendit dhe ato ndërkombëtare, dhe të krijohet Fondi i Restitucionit në Kosovë që do ta definojë kompenzimin për kontestet eventuale rreth pronës.
- Duke pasur parasysh se transformimi dhe privatizimi i NSH-ve është shumë i rëndësishëm dhe sensitiv, ne rekomandojmë kyçjen e shoqërisë Kosovare – partive politike, shoqërisë civile dhe mediave në krijimin e atmosferës positive dhe shpejtimin e reformave kah ekonomia e tregut.

Pjesa I

Hyrje

Objektivat

Objektivat kryesore të këtij hulumtimi ishin: (i) të informojë mbi gjendjen ekonomike dhe financiare të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) në Kosovë, dhe (ii) ta shfrytëzojë këtë hulumtim si një input të rëndësishëm në krijimin e strategjisë për ta përkrahur privatizimin e këtyre ndërmarrjeve. Mostra e hulumtimit ka përfshirë sidomos ato ndërmarrje që kishin pjesëmarrje dominante në aktivitetin ekonomik, punësim dhe eksport para vitit 1989. Hulumtimi ka përfshirë ndërmarrjet kyçe që do të kishin prioritet në procesin e transformimit, privatizimit dhe regjenerimit teknologjik. Objektivi specifik ishte realizimi i analizave më të thella mbi gjendjen e NSH-ve, e sidomos gjendja e tyre financiare dhe kapitalit fiks, si elemente themelore në përgatitjen e ofertës për transformim dhe privatizim. Duke ditur se shumica e NSH-ve nuk kanë dokumentacion të nevojshëm mbi vlerën e kapitalit fiks, anketimi është bazuar në vlerën e kapitalit të vlerësuar nga menxhmenti i këtyre ndërmarrjeve.

Hulumtimi është realizuar nga Instituti për Hulumtime Zhvillimore, RIINVEST, në bashëpunim me Qendrën Ndërkombëtare për Ndërmarrjet Private (CIPE) nga Uashingtoni, dhe me mbështetjen e Agjensisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Ky raport përfaqëson njërin prej aktiviteteve fillestare në kuadër të zhvillimit të Strategjisë së Privatizimit për Kosovën. Ky është pjesë e një projekti më të madh të mbështetur nga USAID të cilin RIINVEST-i është duke e realizuar me CIPE-n, të titulluar "Promovimi i Zhvillimit Ekonomik përmes Shoqërisë Civile". Anketimi gjithashtu është i lidhur me rezultatet e 18 Grupeve Punuese të cilin e ka organizuar RIINVEST-I më 1999 për ta vlerësuar gjendjen në NSH. Anketimi ishte shumë i rëndësishëm për t'i identifikuar ndryshimet në funksionimin e veprimtarisë prodhuese, punësimin dhe angazhimin e NSH-ve në procesin e rindërtimit të Kosovës.

Gjatë periudhës së pas luftës, aktiviteti i një numri të konsiderueshëm të NSH-ve është revitalizuar pjesërisht, por në rrethana mjaft të pa favorshme, me një nivel të ultë të shfrytëzimit të kapaciteteve dhe aktivizimit potencial të tyre, dhe me mbështetjen shumë të vogël nga donatorët.

Performanca më e kënaqshme është regjistruar në hoteleri dhe sektorët tjerë të shërbimeve. Kapacitetet e prodhimit ushqimor, prodhimit të materialit ndërtimorë nuk janë riaktivizuar ashtu siç është pritur. Në anën tjetër, ndërmarrjet në pronësi private janë riaktivizuar shpejt dhe u janë përgjigjur efektivisht kërkesave të tregut dhe projekteve të rindërtimit të Kosovës në përgjithësi.

Arsyet kryesore për një riaktivizim jo-efikas të NSH-ve qëndrojnë në:

- Erozionin teknologjik si rezultat i menaxhmentit të dhunshëm gjatë 10 viteve të fundit;
- Shkatërrimet e mëdha dhe dëmet e shkaktuara nga lufta;
- Mungesa e kapitalit;
- Teknologjia e vjetëruar;
- Vështirësitë e tregut;
- Mungesa e mbështetjes financiare,
- Mungesa e kornizës ligjore që do ta stimulonte aktivitetin ekonomik dhe transformimin.

Përveq përpjekjeve që janë bërë për ta ngritur nivelin e kuptimit të esencës së ndërmarrjeve shoqërore brenda shoqërisë Kosovare dhe nevojën për transformim, komuniteti ndërkombëtar ende është i paçartë rreth njohjes së nevojës për fillimin e procesit të privatizimit të NSH-ve, si metodë themelore e transformimit të pronës. Në vend se të pranojë privatizimin, UNMIK-u ka ofruar metodën e komercializimit (dhënies me qira) e cila, sipas mendimit tonë nuk i plotëson nevojat reale për reforma ekonomike themelore dhe zhvillimin e ekonomisë së tregut, për shkak se e ruan strukturën ekzistuese të pronës shoqërore.

Ne besojmë se krijimi i bazës së të dhënave si një output nga anketa e RIINVEST-it do të ofrojë një mundësi më të mire për t'i vlerësuar më mire modelet dhe metodat më efikase të privatizimit për sektorët e veçantë të ekonomisë së Kosovës.

Ne shpresojmë se ky raport, dhe pas aktivitetëve të cilat do të shpiejnë deri te Strategjia e Privatizimit në Kosovë, do të ndihmojë në eliminimin e dyshimit të opinionit që ekziston për privatizimin, dhe do ta ngrit vetëdijën e komunitetit ndërkombëtar dhe atij Kosovar se privatizimi është i vetmi option drejt rrugës për ta ndërtuar strukturën e ekonomisë së tregut dhe demokratizimit të shoqërisë Kosovare.

Përmbajtja e Raportit

Pjesa e parë e raportit përmban një evoluim të gjendjes aktuale dhe nivelin e aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve shoqërore (NSH), bazuar në anketën e RIINVEST-it me 192 NSH të realizuar gjatë periudhës Tetor – Nëntor, 2000. Pjesa e dytë e raportit fokusohet në çështjet më të mëdha të transformimit/privatizimit të NSH-ve, duke përfshirë analizat dhe komentet e RIINVEST-it mbi vendimet e marrura për reformat ekonomike dhe transformimin e pronës deri më sot. Të dhënat statistikore janë prezentuar në seritë e anekseve në fund të raportit. Është përfshirë edhe kopja e pyetësorit anketues.

Anketimi i shqyrton qështjet specifike si vijon:

- Vlerësimi i gjendjes aktuale në NSH (prodhimi, kërkesat, obligimet, stoqet, apsektet financiare dhe investimet);
- Shfrytëzimi i kapaciteteve dhe teknologjia;
- Personeli;
- Tregu;
- Krjimi i bazës së të dhënave që do të shfrytëzohej në Kosovë për përgatitjen e ofertës për privatizim;
- Shfrytëzimi rezultateve të këtij anketimi për t'i përkrahur aktivitetet e UNMIK-ut, organizatave financiare ndërkombëtare, vet ndërmarrjeve shoqërore, OJQ-ve dhe investitorëve potencial për ta ndihmuar privatizimin dhe ristrukturimin e NSH-ve.

Metodologjia a Hulumtimit

Mostra e anketimit ka përfshirë 192 ndërmarrje shoqërore, ose 55% e numrit të tërësishëm prej 350 ndërmarrjeve që janë aktive dhe jo aktive. Në anketim janë përfshirë NSH që janë të rëndësishme për procesin e transformimit, privatizimit dhe regjenerimit teknologjik. Ndërmarrjet e anketuara i takojnë kryesisht grupit të ndërmarrjeve të “mesme” dhe të “mëdha”. Mostra gjithashtu ka përfshirë 12 NSH në Gjakovë të cilat ishin transformuar në shoqëri aksionare sipas ligjit të ish-Jugosllavisë gjatë vitit 1990/1991.

Anketimi ka përfshirë ndërmarrjet shoqërore nga sektorët si më poshtë:

- Industri
 - Prodhimi i ushqimit
 - Metalopërpunuese dhe paisje elektrike
 - Material ndërtimorë
 - Kimike, letër dhe plastikë
 - Tekstil dhe lëkurë
 - Përpunim druri
 - Grafikë
 - Gomë
- Ndërtimtari
- Tregti
- Bujqësi
- Turizëm
- Shërbime

- Transport
- Minierale
- Të tjera

Anketimi është realizuar në 24 komuna të Kosovës por më shumë ishte fokusuar në këto komuna: Prishtinë (14% e të anketuarve), Gjakovë (11%), Pejë (8%), Prizren (7%), Gjiilan (7%), dhe Ferizaj (6%). Mostra ka përfshirë të gjitha ndërmarrjet e rëndësishme të cilat do të targetoheshin në fazën e pare të privatizimit. Anketimi nuk ka përfshirë ndërmarrjet publike komunale, kooperativat bujqësore, kompleksin Trepça, Ferronikel, telekomunikimet, temocentralet dhe minierat e thëngjillit. Për sa u përket ndërmarrjeve publike komunale, shumica prej tyre kanë marrë asistencë teknike dhe financiare, prandaj ato mund të konsiderohen si të aktivizuara. Aktualisht, një konzorcium ndërkombëtar është duke e menaxhuar kopleksin Trepça (minierat dhe industrinë e metalurgjisë), i cili do të sygjerojë se çfarë duhet të bëhet më qëllim që të aktivizohen kapacitetet e saj. Sa i përket Ferronikelit, duhet të theksojmë se është hapur tenderi për komercializimin e tij.

Pyetëtori (shiko në aneksin II) përbëhet nga këta kapituj:

- (1) PRODHIMTARIA
- (2) KAPACITETET
- (3) SHPENZIMET DHE FITIMI
- (4) PERSONELI
- (5) TEKNOLOGJIA
- (6) KËRKESAT DHE OBLIGIMET
- (7) MJETET E XHIROS
- (8) INVESTIMET

Pyetëtori ishte përpiluar në atë mënyrë që të behet e mundur nxjerrja e konkluzioneve mbi:

- Nivelin e aktiviteve (transaksionet, shfrytëzimi i kapaciteteve, tregjet, punësimi);
- Niveli teknik dhe teknologjik;
- Struktura e personelit; dhe
- Aktivitetet investuese.

Në seksionin e dytë, pyetjet ishin formuluar ashtu që do të bëjë të mundur evoluimin kualitativ të problemeve që e pengojnë afarizmin, kushtet në të cilat ato operojnë, dhe mbi privatizimin ose format tjera të transformimit pronësorë.

Pas definimit të qëllimeve të anketimit dhe përpilimin e pyetësorit, është bërë trajnimi i anketuesve për punën e tyre në terren. Ata janë njohtuar si me kategoritë ekonomike të përfshira në anketë, ashtu edhe me çështjet metodologjike dhe psikologjike. Anketimi është realizuar nga 20 studentë të vitit të katërt të Fakultetit Ekonomik, të cilët kanë pasur përvoja edhe nga anketimet e mëparshme të ngjashme që janë oragnizuar nga RIINVEST-i. Administrimi i anketimit ka zgjatur 2 javë, ndërsa dy javë tjera ishin të nevojshme për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave. Ndërkohë, 10% e ndërmarrjeve të anketuara janë rishikuar për qëllimet e kontrollit logjik dhe atij praktik. Të anketuarit kanë kontaktuar drejtpërdrejtë me drejtorët e ndërmarrjeve, drejtorët e financave ose personat e autorizuar nga menaxhmenti i ndërmarrjes. Raporti mbi anketimin është i ndarë në kapituj sipas titujve të seksioneve kryesore në pyetësorë.

CIPE dhe USAID kanë ofruar kontribut të çmueshëm në kompletimin e këtij anketimi dhe raportit, dhe është inkurajuar angazhimi i mëtutjeshëm i përfaqësuesve të USAID-it. Ideja dhe intersimi për ta realizuar një anketim të tillë erdhi si rezultat i kontakteve të shumta me këto dy institucione të rëndësishme të angzhuara në rindërtimin e Kosovës. Falenderime të veçanta gjithashtu u takojnë administratorëve të tyre për punën e madhe dhe çasjen profesionale. Së fundi, dhe ndoshta për kontributin më të rëndësishëm, i falendërojmë përfaqësuesit e ndërmarrjeve shoqërore për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e tyre gjatë realizimit të anketimit.

Pjesa II

Rezultatet e anketës

I. NIVELI I AKTIVITETIT EKONOMIK TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Niveli i Riaktivizimit

Konkluzion i përgjithshëm rreth nivelit aktual të aktivitetit të ndërmarrjeve shoqërore është se pjesa dërmuese e tyre formalisht e kanë rifilluar aktivitetin e tyre ekonomik pas luftës. Nga gjithsejt 192 ndërmarrje shoqërore të anketuara 165 ose 86% e tyre janë aktive, ndërsa 14% ende nuk e kanë rifilluar aktivitetin e tyre (shih tabelën 1 në aneksin statistikor).

Niveli i aktivitetit të ndërmarrjeve shoqërore (NSH) – përmirësim gradual

Viti	1999	2000
NSH Aktive	55 – 60%	86%
Shfrytëzimi I Kapaciteteve	28%	35%
Qarkullimi/Shitja	100	257
Numri I Punëtorëve Aktiv	18,171	24,662
Numri I Punëtorëve të Regjistruar	36,023	42,581
Paga Mesatare		200 DEM

Vitin e kaluar në të njëjtën periudhë, sipas vlerësimeve kanë qenë aktivizuar rreth 60% e ndërmarrjeve shoqërore. Përkah shkalla e aktivizimit vendin e parë e zënë ndërmarrjet në tregëti, industri grafike, industria e përpunimit të drurit dhe e shërbimeve me 100% të ndërmarrjeve të aktivizuara. Përkah shkalla e lartë e aktivizimit në vend të dytë vijnë ndërmarrjet nga lëmia e bujqësisë dhe turizmit me nga 92% (nga 25 ndërmarrje të anketuara 23 janë aktive). Nga 11 ndërmarrjet e industrisë së tekstilit 10 janë aktive ose 91%, pastaj me radhë vijnë ndërmarrjet e transportit me 89% shkallë të aktivitetit, ndërtimtarisë me 86%, metalopërpunuese 83%, industrisë kimike, plastike dhe të letres 83%, etj.

Ndërmarrjet nga dega e agroindustrisë të cilat janë të prezentuara në 37 anketa 78% janë aktive pra nën mesataren e shkallës së aktivitetit të ndërmarrjeve shoqërore nga

lëmia e industrisë. Përgjysmë nën mesataren për kah shkalla e aktivizimit janë edhe industria e gomës dhe xehetaria.

Vështruar për nga aspekti rajonal shkalla e aktivizimit të ndërmarrjeve është shumë më e ulët në komunat e pazhvilluara si dhe të komunave të dëmtuara nga lufta. Nga 27 ndërmarrjet shoqërore joaktive, 20 janë nga komunat e pazhvilluara. Në Skenderaj nga 4 ndërmarrje, në Lipjan dy, Në Deçan e Klinë nuk janë aktive nga dy ,pastaj në Glogoc dy , në Fushë Kosovë dhe Podujevë nga tri.

Shfrytëzimi i kapaciteteve

Shfrytëzimi i kapaciteteve të ndërmarrjeve të anketuara në periudhën 1988-1999 shënon rënje drastike, nga 76% në vetën 28%. Të dhënat për vitin 2000 tregojnë se këto ndërmarrje vetëm një vit pas përfundimit të luftës e kanë një përmirësim të ngadalshëm të shkallës së shfrytëzimit të kapaciteteve dhe atë për 7%.

Shkaqet e një gjendjeje të këtillë në shfrytëzimin e kapaciteteve duhet të kërkohen në pozitën e rendë të tyre gjatë periudhës së kaluar 10 vjeçare dhe dëmet e mëdha të shkaktuara nga lufta, rrënimin e shumë objekteve dhe plaçkitjen e paisjeve.

Tek disa lëmi ekonomike përveç pasojave të lartpërmendura si duket ndikim ka pasë edhe konsolidimi shumë i shpejtë i sektorit privat si në ndërtimtari, tregëti, hoteljeri e turizëm, transport etj. Përndryshe një vit pas përfundimit të luftës vëllimi i punëve në ndërtimtari ka qenë shumë më i madh se sa në vitet e para luftës. Qarkullimi i mallit tregëtar poashtu është shtuar dukshëm kurse në anën tjetër shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve të ndërmarrjeve të anketuara nga këto lëmi është tejte e ulët gjë që flet për vështërsitë e mëdha në aktivizimin e tyre.

Në bazë të konkluzioneve të nxjerra nga bisedat me menaxherët e ndërmarrjeve të anketuara rezulton se pengesa kryesore për aktivizimin e ndërmarrjeve shoqërore paraqesin:

(a) Mungesa e kapitalit gjegjësisht mungesa e mjeteve investive për të bërë intervenime të nevojshme për aftësimin e tyre për prodhim. Ky faktor më shumë ndikim ka te ndërmarrjet e përpunimit të drurit, te ndërmarrjet tregëtare, shërbimet ;

(b) Mungesa e mjeteve të xhiros është problem tjetër më i theksuar, sidomos në tregëti, shërbime, industrinë metalopërpunuese, etj.


(c) Lënda e pare paraqet pengesë për riaktivizim të ndërmarrjeve të cilat mvaren nga importi i saj. Veqanërisht kjo është e theksuar te industria metalopërpunuese, te paisjet elektrike e të ngjashme.

(ç) Teknologjia e vjetëruar dhe e shkatërruar nga lufta e cila kërkon intervenime për gjenerim dhe ka vështërsi të jetë konkurente në treg,

(e) Objektet e dëmtuara dhe në disponim të përkohëshëm nga KFOR-i dhe UNMIK-u,

(g) Mungesa e ligjeve të cilat rregullojnë marrëdhënjet në sferën e prodhimit, mosaktivizimi i bankave afariste dhe institucioneve tjera financiare.

Shfrytëzimi i kapaciteteve nga NSH



Një analizë e shkaqeve që ndikojnë në nivelin e ulët të shfrytëzimit të kapaciteteve shpie në konkludim se shumica e problemeve janë të ndërlidhura me problematikën e pozitës së padefinuar juridike të këtyre ndërmarrjeve, si dhe mundësitë shumë të kufizuara të qasjes së këtyre ndërmarrjeve kapitalit financiar dhe kapitalit punues nga burimet eksterne në kushte të fuqisë së tyre të vogël që me mjetet e veta të përballojnë nevojat e tyre financiare.

Menaxherët e ndërmarrjeve shoqërore ishin kritik sidomos ndaj sistemit aktual të tatimeve.

- Shumica e NSH (73.2%) kanë deklaruar se tatimet dhe doganat aktuale paraqesin pengesa për ristartimin e afarizmit të tyre; vetëm 9.8% i klasifikojnë tatimet dhe doganat si stimulative.
- Në përgjithësi, NSH të anketuara rekomandojnë se importi i lëndëve të para duhet të lirohet nga pagesa e doganës së paku për periudhën dy vjeçare, që do të ishte një element i ringjalljes dhe ristartimit të ndërmarrjeve.
- Ndërmarrjet e anketuara deklaruan se lirimet nga doganat duhet të bëhen për ndërmarrjet që importojnë teknologjinë e nevojshme dhe paisjet për ta riparuar teknologjinë e dëmtuar ose vjedhur, si dhe për aktivitetet e prodhimit të bujqësore.
- Paradoksi i pagesës së tatimeve në lëndë të para dhe prodhime finale duhet të mënjanohet (për shembull tatimimi i grurit si lëndë e parë për prodhimet ushqimore, ndërsa në anën tjetër prodhimet finale siç është mielli nuk tatimohet).
- Doganat në lëndë të para duhet të hiqen.
- Prefencat doganore që i bëhen IRJM-së nuk janë konsideruar të përshtatshme.
- Gjithashtu, taksat e imponuara nga Mali i Zi dhe IRJM për mallrat transit për importet e Kosovës janë konsideruar si të pa drejta.

Si pjesë e përpjekjeve për rifillimin e aktiviteteve, mbi 50% e NSH deklarohen se ato kanë të përgatitur planet e biznesit dhe ato janë të njohura për opinionin. Kjo tregon se asistencë teknike është e domosdoshme për të ndihmuar strategjinë e ndërmarrjeve të diferencuar dhe pozitën e tyre në treg.

II. REZULTATET FINANCIARE

1. Vëllimi i shitjes

Lidhur me pasqyrimin e vëllimit të shitjes për vitin 1989 të dhënat duhet të merren me rezervë për shkak të kursit jo real të konvertimit të dinarit në DEM.

Periodha e viteve 1999 dhe 2000 është më lehtë të pasqyrohet në rezultatet financiare meqenëse për këtë periudhë mjet zyrtar pagese është DEM. Në përgjithësi të gjitha degët e industrisë dhe fushat tjera ekonomike në vitin 2000 kanë realizuar rritje të vëllimit të shitjes. Në bazë të të dhënave të 121 ndërmarrjeve të cilat e kanë treguar vëllimin e prodhimit të realizuar për këto dy vite del se në vitin 2000 realizimi në këto ndërmarrje ishte 2,72 herë më i madh se sa në vitin paraprak. Kjo dinamikë është edhe më e madhe kur mirret parasysh se të dhënat për vitin 2000 nuk janë për tërë vitin (rezultatet përfshijnë periudhën Janar Shtator).

Analiza e struktures së dinamikës së prodhimit në këtë periudhë (shih tabelën 3 në aneksin statistikor) tregon se industria dhe shërbimet e kanë rritur qarkullimin e tyre mbi mesatare, ndërsa vetëm tregtia (-1.6%) dhe bujqësia (-44.7%) shënuan rënie në shitje në krahasim me vitin paraprak. Rritje më dinamike ka pasë agroindustria (569%), industria metalopërpunuese (249,5%), pastaj industria e tekstilit, përpunimit të drurit, grafike, e gomës, ndërtimtaria, turizmi, shërbimet dhe transporti.

Në anën tjetër në vitin 2000 në krahasim me vitin paraprak rënie e shitjes është paraqitur vetëm te tregëtia (21.8%) dhe bujqësia (16.3 %).

2. Shpenzimet

Në bazë të të dhënave të anketës shifet se shpenzimet mesatare për një ndërmarrje në vitet 1988 dhe 1989 ishin shumë më të larta se sa në vitet 1999 dhe 2000. Pjesëmarrja e shpenzimeve në realizimin e gjithëmbarshtëm tregon një trend pozitiv, gjegjësisht një zvoglim të pjesëmarrjes së shpenzimeve. Kështu nga të dhënat për shpenzimet mesatare të ndërmarrjeve në vitin 1988 shifet se shpenzimet përbënin 74% të vlerës së shitjes kurse në vitin 2000 ato kanë rënë në 46%.


3. Të ardhurat personale

Masa e mjeteve për të ardhura personale është po ashtu e vogël edhe për shkak se shumë nga këto ndërmarrje kanë aktivitet ekonomik minimal ose nuk kanë fare aktivitet ekonomik por më tepër të punësuarit angazhohen për ruajtjen nga keqpërdorimi ose shkatërrimi i objekteve dhe paisjeve. Në mungesë të mjeteve për rifillimin e punës ato kanë filluar pjesërisht të funksionojnë dhe për këtë arsye një pjesë të punëtorve i pagujnë në shtëpi ose më shumë të tjerë pushojnë pa pagesë.

Në bazë të të dhënave del se në vitin 1988 për një të punësuar janë paguar 5.433 DEM në vit ose 453 DEM në muaj , kurse në vitin 2000 në periudhën janar- shtator janë paguar gjithsejt 1.900 DEM për një të punësuar ose mesatarisht nga 210 DEM në muaj. Niveli i të ardhurave personale në krahasim me ndërmmarrjet private është rreth 2,3 herë më i vogël.

4. Fitimi / Humbja

Shuma e mjeteve të deklaruar si fitim në vitin 2000 përbën 9,5% të vlerës së shitjes . Masa e fitimit në nëntë muajt e parë të vitit 2000 është 3.5 herë më e madhe se sa e vitit paraprak. Në anën tjetër nga gjithsejt 131 ndërmarrje sa janë përgjegjë në këtë pyetje vetëm 13 kanë punuar me humbje ose 10% e tyre. Ato kanë pasë humbje në masën prej 7% të fitimit të gjithëmbarshtëm. Natyrisht në kushtet në të cilat veprojnë ndërmarrjet e anketuara të dhënat mbi fitimin duhet të kufizohen më shumë si llogaritje teknike financiare se sa si rezultat substancial financiar.



5. Mjetet e Xhiros

Është inetersant se vëllimi i stokeve në këto ndërmarrje është i konsiderueshëm. Struktura e stokeve gjegjësisht mjeteve të xhiros nuk është e pavolitshme. Edhe pse vetëm në bazë të të dhënave të anketës është vështirë të analizohet aspekti kualitativ I kësaj structure. Fakti se mbi 45% e mjeteve të xhiros janë material dhe lendë e parë dhe kapital financiar dhe vetëm 27% stoke të produkteve të gatshme kërkon një analizë më cilsore.

Nga ana tjetër vlera e stokeve të lëndës së pare dhe e prodhimeve të gatshme përbën një vlerë sa 43,5% e shitjes së gjithmbarshme në vitin 2000. Kjo tregon se ndërmarrjet shoqërore kanë disproporcion në procesin e sigurimit të lëndës së pare nga një anë dhe shfrytëzimit të kapaciteteve prodhuese dhe të shitjes në anën tjetër.

Rreth 50% e ndërmarrjeve deklaruan se kanë stoke të lëndëve të para ndërsa 43% e tyre kanë regjistruar stoke në formë të prodhimeve të gatshme. Prandaj ne mund të konkludojmë se disa ndërmarrje kanë stoke të lëndëve të para por jo edhe gatishmëri teknologjike për prodhim. Ose, disa ndërmarrje kanë prodhime të gatshme por nuk kanë treg, ose ndeshen me pengesa administrative për eksportimin e tyre. Kapitali financiar është i koncentruar në lëminë e hotelarisë dhe të turizmit. Kapitali financiar në veprimtaritë tjera (pa turizmin e hotelarinë) paraqet vetim 5% të stokeve, çka prap na sjell te konkluzioni se ndërmarrjet shoqërore kanë probleme evidente në harmonizimin e proceseve në faza të ndryshme të prodhimit. Ndërmarrjet nga lëmia e turizmit dhe e hotelarisë disponojnë me mbi 50% të kapitalit financiar të të gjitha ndërmarrjeve.

Pasqyrë e strukture së stokeve dhe rezervave të lëndës së parë

Nr	Emërtimi	Nr.i ndërmarrjeve	Shuma	Struktura
A	Material dhe lëndë të para	97	91,899,615	44,6%
B	Stoqet në produkte të gatshme	83	55,514,406	27,0%
C	Kërkesat	74	38,9,6,278	18,9%
D	Kapitali financiar	67	19,554,075	9,5%
	Gjithsej	-	205,874,374	100,0%

Është brengosese se pjesa më e madhe e kapitalit financiar që e disponojnë këto ndërmarrje ruhet në formë të keshit dhe shumë më pak në xhirologari dhe në forma tjera. Kjo për rrethanat tona edhe është normale kur në Kosovë operon vetën një bankë përmes së cilës mund të kryhen veprimet e nevojshme financiare.

6.Kërkesat dhe obligimet

Afër 41% e ndërmarrjeve shoqërore kanë deklaruar se kanë kërkesa dhe obligime. Obligimet e përgjithsme (76 Milion DEM) janë dyfish më të mëdha se sa kërkesat (38 milion DEM – tabelat 4 dhe 5 në aneksin statistikor). Në anën tjetër ndërmarrjet të cilat kanë deklaruar obligime mesatarisht kanë rreth një million DEM obligime e që në kushtet e dhëna nuk është për të u nënçmuar. Nga anketa poashtu shifet se mesatarja e shitjes së realizuar të ndërmarrjeve është rreth 2.2 milion DEM. Pra ndërmarrjet të cilat kanë obligime mesatarisht kanë gjysmën e prodhimit vjetor obligime. Rreth 2/3 e kërkesave dhe 83% e obligimeve i takojnë industrisë metalo-përpunuese. Në kuadër të strukturës së obligimeve, mbizotrojnë kreditë afatgjata nga bankat dhe institucionet tjera. Rreth 12% e kërkesave janë ndaj ndërmarrjeve nga Serbia.

III. PROBLEMATIKA E TREGUT DHE EKSPORTIT

Kjo anketë ka dëshmuar se tregu i këtyre ndërmarrjeve është i redukuar dhe i ndryshuar radikalisht në vitin 2000. Vetëm 1 % e shitjes realizohet përmes eksportit. Aktiviteti ekonomik i ndërmarrjeve shoqërore të anketuara në të kaluarën ishte i orientuar në tregun e mbrendshëm por një numër i madh i këtyre ndërmarrjeve edhe në eksport. Disa nga këto kapacitete u bënë burim tejet i rëndësishëm i eksportit të Kosovës. Në vitin 1989 eksportues më të mëdhenjë ishin industria e akumulatorëve (61.7 mil.DEM), Feronikli (189.3 mil.DEM), Elektromotori i Gjakovës (40.0 mil.DEM) dhe fabrika e amortizierëve (20.0 mil.DEM). Riaktivizimi i këtyre kapaciteteve është i kushtëzuar me eliminimin e dëmeve nga konflikti ushtarak (108.9 mil.DEM) dhe sigurimi i investimeve të nevojshme për riaktivizim të aktivitetit ekonomik dhe eksportues.

Konsolidimi afatmesëm i këtyre kapaciteteve kërkon investime më serioze duke pasur parasysh ngecjen në zhvillimin teknologjik të këtyre ndërmarrjeve. Mungesa e këtyre investimeve do ta vështirësojnë mbijetesën në treg të hapur të eksportuesve Kosovar duke pasur parasysh zhvillimin teknologjik të konkurrentëve në rajon dhe në treg botëror. Ndërmarrjet shoqërore aktualisht kanë vështirësi të përballen edhe me tregun e Kosovës dhe me nevojat e rindërtimit. Këto ndërmarrje më një status të paqartësuar sa i përket transformimit dhe privatizimit të tyre vështirë se do të rikthejnë pozitën eksportuese në tregun e jashtëm duke pasur parasysh ndryshimet radikale të këtij tregu në 10 vjetshin e fundit (zhdukja e tregut kliring, rrënimi i sistemit socialist, zhvillimi i tranzicionit në vendet postkomuniste, krijimi i shteteve të reja, zhvillimi i proceseve integruese në rajon, krijimi i zonave doganore dhe tregëtare të lira). Prandaj rikthimi i ekonomisë së Kosovës në treg ndërkombëtar është i kushtëzuar me ndikimin e shumë faktorëve dhe rrethanave të reja.

Intensiteti i ndryshimeve të shitjeve në treg (%)

Vitet	Tregu i mbrendshëm	Tregu i ish Jugosllavisë	Tregu i jashtëm	Gjithsej
1988	47.1	31.4	21.5	100.0
1989	46.4	34.8	18.8	100.0
1999	87.3	10.1	2.6	100.0
2000	98.9	0.3	0.7	100.0

Pas viteve 1988/1989 vijnë në shprehje ndryshime të mëdha në aktivitetin ekonomik të ndërmarrjeve shoqërore si rezultat i instalimit të administrimit të dhunshëm. Kjo gjendje është reflektuar negativisht sidomos në aktivitetin eksportues dhe në tërësi në bashkëpunimin ekonomik me botën e jashtme. Sipas rezultateve të anketës në vitin 1988 afro 50 % e prodhimit të ndërmarrjeve shoqërore është realizuar në tregjet e ish Jugosllavisë dhe të jashtme, ndërsa tregu i mbrendshëm ka apsorbuar 47.1 % të prodhimit. Në këtë vit 44 ndërmarrje kishin krijuar lidhje ekonomike me këto tregje.

Disa kapacitete mund të rikthehen në treg ndërkombëtar edhe me investime jo aqë të mëdha. Këtu në radhë të parë mendohet në riaktivizimin e eksportit në ndërmarrjet për prodhimin e akumulatorëve, amortizerëve, gomes dhe të verës.

Riaktivizimi i prodhimit dhe i eksportit në Feronikel dhe në kompleksin e industrisë së tekstilit dhe lëkurës është i kushtëzuar me investime serioze në eliminimin e dëmeve nga konflikti ushtarak, eliminimi i ngecjes në zhvillimin teknologjik dhe ristrukturimi intenziv sipas kriterëve të tregut ndërkombëtar.

Pengesë serioze për riaktivizimin e sektorëve dhe ndërmarrjeve eksportuese është mungesa e kornizave legale për rregullimin e mardhënieve me botën e jashtme e sidomos për realizimin e eksportit dhe të formave të larta të bashkëpunimit ekonomik. Edhe përkundër rekomandimeve të Bankës Botërore që Kosova të fitoi statusin e një entiteti ndërkombëtar tregtar dhe doganor, Komuniteti Ndërkombëtar (UNMIK) akoma nuk e ka kompletuar legjislacionin për krijimin e një rrethine institucionale në favor të eksportit dhe të bashkëpunimit me botën e jashtme.

IV.PERSONELI

1. Shkalla e Aktivizimit dhe Struktura Kualifikuese


Nga të dhënat statistikore dihet se në sektorin shoqëror të ekonomisë në vitin 1989 ishin të punësuar rreth 170 mijë punëtorë. Me futjen e masave të dhunëshme në ekonomi nga ana e Serbisë u larguan nga puna për motive politike një numër i madh i punëtorve të këtyre ndërmarrjeve. Të dhënat e anketës për vitin 1989 flasin për 77.560 persona të punësuar në 153 ndërmarrje shoqërore të anketuara. Nëse gjykojmë sipas numrit mesatar të të punësuarve ndërmarrjet e anketuara do të kishin rreth 100 mijë të punësuar e që anketën e bën mjaft reprezentative kur mirret parasysh se në anketim nuk janë përfshi komplekset e mëdha metalurgjia dhe xehtaria e “Trepçës” dhe “Elektroekonomia” ,Feronikeli, telekomunikimet dhe ndërmarrjet komunale publike.

Mund të konkludohet se numri i punëtorve që aktualisht është aktiv në ndërmarrjet shoqërore është zvogëluar dukshëm në krahasim me vitin 1989. Tani rregullisht punojnë vetëm rreth 25% e numrit të punëtorëve në atë kohë.

Në vitin 2000 numri i punëtorve të evidentuar në 187 ndërmarrje të cilat kanë dhënë përgjigje në këtë pyetje është 42.581 veta. Nga ky numër vetëm 58% janë vazhdimisht të angazhuar në punë. Sipas të dhënave të anketës me 1989 rreth 62% e të punësuarve ishin të punësuar në 95 ndërmarrje që kanë prej 100 deri në 800 punëtor. Në vitin 2000 mesatarja e numrit të të punësuarve për një ndërmarrje bie dukshëm. Në 127 ndërmarrje që punësojnë 50 deri 400 punëtorë janë të punësuar 64% e të punësuarve.

Pasqyrë e grupimit të ndërmarrjeve sipas numrit të punëtorëve

Nr. i ndërmarrjeve	Nr. i punëtorëve
35	Deri - 50
38	51-100
44	101-200
45	201-400
15	401-800
9	801-1200
1	1200-2000
Gjithsej 187	



Zvoglimi i dukshëm i numrit të punëtorve është karakteristikë e të gjitha degëve të industrisë dhe e veprimtarive tjera ekonomike, ndonëse me dinamikë jo të njejtë. Dinamikë më të ngadalshme punësimi kanë realizuar agroindustria, industria metalopërpunuese, industria kimike, industria e drurit, e gomës dhe turizmi.

Rreth 8.5% e punëtorve të ndërmarrjeve të anketuara aktualisht gjinden në botën e jashtme por mbahen në evidence në ndërmarrjet përkatëse. Këta janë persona të cilët pas largimit me dhunë nga puna ose gjatë luftës u detyruan të migrojnë dhe të cilët ende nuk janë kthyer në ndërmarrjet përkatëse.

Rreth 36.7% të punëtorëve që vetëm janë të evidentuar por faktikisht nuk punojnë dhe nuk marrin kurrëfarë pagash prandaj rrijnë në shtëpi. Kur këtij numri i shtohet edhe numri i atyre që marrin paga simbolike por nuk punojnë fare struktura e aktivitetit të punëtorve të evidentuar në ndërmarrjet e anketuara është tejte e pavoritshme.

Sidomos me këtë problem është e ngarkuar industria metalopërpunuese me rreth 60% të punëtorve të evidentuar të cilët nuk janë fare aktiv.

Sa i përket strukture kualifikuese të të punësuarve anketa tregon se pjesa më e madhe e tyre kanë kualifikimin e mesëm. Struktura e pavolitshme kualifikuese është sidomos në industrinë e drurit, në industrinë grafike. Në të tjerat përqindja e të punësuarve me shkollë të lartë dhe fakultet sillet prej 7% te materiali ndërtimor deri në 18% te agroindustria (shih tabelën 7 në aneksin statistikor).

2. Stafi udhëheqës

Shikuar përnga kualifikimi formal struktura e stafit nuk është shumë e pavolitshme. Rreth 66% janë me kualifikim të lartë. Në agroindustri, industri të përpunimit të drurit, të gomës, tregëti dhe xehtari mbi 70% e stafit udhëheqës të këtyre ndërmarrjeve është me kualifikim superior.

Struktura kualifikuese e stafit udhëheqës

	Kualifikimi	Numri	%
1	Suprior	954	50
2	I lartë	314	16
3	I mesëm	532	28
4	Të tjerë	124	6
	Gjithsej	1,924	100

3. Mosha e të punësuarve

Të dhënat e anketës tregojnë se mosha e të punësuarve në ndërmarrjet e anketuara është relativisht e vjetër. Kjo është e pritur për arsye krejt të njohura. Në dhjetë vitet e kaluara fare pak ose fare është përtërirë përbërja e të punësuarve. Në ndërmarrjet shoqërore kryesisht gjindet ai personel që ka qenë para dhjetë vitesh që ka mbetë në punë ose është kthyer pas lufte. Të rinjtë që kanë zënë punë në vitet e fundit janë angazhuar kryesisht në sektorin privat. Prandaj, mbi 90% e të punësuarve në ndërmarrjet shoqërore është e moshës mbi 30 vjeç.

Struktura moshore e të punësuarve në ndërmarrjet shoqërore

Nr	Viti 2000		
	Grupmoshat	Nr. i punëtorëve	%
1	20 – 30	3,984	10
2	30 – 40	14,280	37
3	40 – 55	15,935	42
4	55 -	4,114	11
	Gjithsej	38,313	100

Strukturën më të volitshme moshore e kanë agroindustria, industria e materialit ndertimor, e gomës, turizmi dhe pylltaria. Përkah mosha e vjetër e punëtorve dallohet sidomos industria e tekstilit dhe xehtaria në të cilat rreth 50% të të punësuarve është e moshës mbi 50 vjeç.

Nga analiza e personelit mund të konstatohet se numri i të punësuarve aktual nuk është ndonjë barrë e madhe për procesin e rishtruktimit dhe privatizimit. Në kushtet e zgjedhjes së problemit të pensionimit ky madje nuk do të ishte problem esencial.

V. KAPITALI FIKS

Pjesa më delikate e kësaj ankete ka qenë pyetja rreth vlerës dhe strukture së kapitalit. Në realitet i tërë dokumentacioni rreth vlerës blerëse të paisjeve dhe objekteve nuk është azhur dhe nganjëherë nuk është komplet ose ka humbur. Andaj vlerësimi i vlerës së tanishme të kapitalit fiks është bërë sipas vlerësimeve të stafeve udhëheqëse që janë anketuar e të cilët janë bazuar në librat e kontabilitetit ose komisioneve të formuara për këtë qëllim.

Kapitali fiks (shih tabelën 8 në aneksin statistikor)

	Mil. DEM	%
Paisjet	1,576	35.3
Ndërtesat	2,022	54.3
Toka	866	29.4
Gjithsej-	4,465	100.0

MESATARJA E AMORTIZIMIT: 55%

40 - 50% NË MATERIAL NDËRTIMORË, TEKSTIL, GRAFIKË, GOMË

50 - 60% NË AGROKOMPLEKS, INDUSTRI PËRPUNUESE, INDUSTRI KIMIKE, TRANSPORT

60 - 70% NË PËRPUNIMIN E DRURIT, NDËRTIMTARI, TURIZËM

Problem tjetër ka paraqitë edhe vlerësimi i mbiçmuar i tokës si pasuri e patundshme. Për këtë arsye vlera e pasurisë së ndërmarrjeve të anketuara e të cilat kanë deklaruar se posedojnë tokë si pasuri të patundëshme e ka rritë pjesëmarrjen e sajë në vlerën e gjithëmbashme të mjeteve themelore në rreth 20%. Para vitit 1989 kjo pjesëmarrje ishte vetëm 0,4%. Kjo pjesëmarrje është e fryer nga se në ndërmarrjet e anketuara nuk kishte ndonjë kriter objektiv për caktimin e vlerës së tokës, por vlera e deklaruar është dhënë sipas një vlerësimi të cilin e kanë bërë strukturat udhëheqëse të ndërmarrjeve.

Pjesëmarrja e vlerës së paisjeve dhe e makinave ka ra nga 52% sa ishte para vitit 1989 në 35,1% në vitin 2000. Pjesëmarrja e objekteve në vlerën e gjithëmbashme të kapitalit të ndërmarrjeve shoqërore ka mbetë e pandryshuar. Ky ndryshim strukturor është i natyrshëm nga dy arsye. Së pari në dhjetë vitet e fundit nuk është investuar fare në përtërirjen ose zëvendësimin e paimeve dhe makinerive me të reja, derisa ato ekzistuese e kanë humbë vlerën e tyre si pasojë e amortizimit (fizik teknologjik), ndërsa një pjesë e paisjeve është dëmtuar në luftë.

Po ashtu nga anketa shifet se shkalla e amortizimit të makinave dhe të paisjeve është e lartë. Përqindja e amortizimit në bazë të përgjigjeve të 180 ndërmarrjeve lëvizë 50-76%. Është karakteristike se degët dhe lëmitë ekonomike të cilat e kanë pjesëmarrjen më të madhe në paisje e kanë edhe shkallën më të lartë të amortizimit (industria metalopërpunuese dhe xehtaria).


Shikuar nga aspekti i ofertës potenciale për privatizim në Kosovë, ajo sipas anketës, do të ishte rreth 4,4 miliard DEM, kurse vetëm paisjet dhe objektet 3,6 miliard DEM. Duhet pasur parasysh faktin se kjo vlerë deri në një masë e mbiçmuar dhe se një pjesë e ndërmarrjeve do të duhej të i nënshtroheshin procesit të bankrotimit. Mirëpo edhe në rast se 50% e masës potenciale e privatizimit do të mund të efektuohej kjo do të përbënte një vlerë prej 1,8 miliard DEM (vetëm në ndërmarrjet e anketuara). Mu për këtë çështja e transformimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe mundësia e efektimit të këtij kapitali ka rëndësi të madhe. Së këndejmi në këto relacione duhet të shihen edhe efektet e mundshme nga privatizimi sipas modeleve të ndryshme.

VI. DËMËT E LUFTËS

Në ndërmarrjet e anketuara dëmet nga lufta kapin shumen prej 21.2% të kapitalit të tyre fizik. Vetëm dhjetë nga gjithsejt 192 ndërmarrje nuk kanë patur dëmë nga lufta. Gati gjysma e tyre (44%) kanë pësuar dëme 1 deri në dhjetë million Dem, kurse 15 % deri në 100 million DEM. Më së shumti dëme kanë pësuar agroindustria, industria metalopërpunuese, e tekstili, bujqësia, transporti, tregëtia etj. Mesatarisht çdo ndërmarrje është dëmtuar për 5,2 milion DEM.

Struktura e dëmeve të luftës

Nr	Emërtimi	Nr. i ndërmarrjeve	Shuma DEM	Mesatarja për një ndërmarrje
1	Ndërtesa dhe objekte tjera	137	360,412,239	2,630,746
2	Pajisjet	159	830,439,508	5,222,890
3	Të tjera (Produkte të gatshme)	87	162,555,287	1,868,452
	Gjithsej		1,353,407,034	7,434,000



VII. INVESTIMET

1. Aktiviteti i Gjertanishëm Investiv

Në periudhën e pasluftës ndërmarrjet e sektorit shoqëror nuk kanë pasë ndonjë aktivitet të theksuar intenziv investiv. Kryesisht është punuar në sanimin e dëmëve të luftës dhe për ristartimin e prodhimit. Në këtë dinamikë të zvogluar investive kanë ndikuar kryesisht mungesa e institucioneve financiare gjegjësisht bankave afariste dhe statusi i pa zgjidhur i këtyre ndërmarrjeve.

Rrethanat e pasigurta dhe mungesa e infrastruktures ligjore në këtë lëmi ka penguar që ndërmarrjet të mos mund të sigurojnë mjete edhe nga burimet e huaja. Për këtë arsye në strukturën e investimeve të gjertanishme kategoria "të tjera" e burimit të investimeve përbën rreth 46% të mjeteve të investuara, donacionet dhe kreditë së bashku 54%.

INVESTIMET

118 NDËRMARRJE APO 61% DEKLAROJNË SE KANË PASUR AKTIVITETE INVESTUSE PAS LUFTËS, MESATARISHT 459,862 DEM

BURIMET E INVESTIMEVE

DONACIONET: 10 MILION DEM

KREDITË: 10,8 MILION DEM

TË TJERA: 17,7 MILION DEM

TOTAL: 38 MILION DEM

Numri më i madh i ndërmarrjeve që kanë pasë aktivitet investiv në këtë periudhë kanë investuar shuma relativisht të vogla. Siq shifet nga anketa rreth 83% e ndërmarrjeve që kanë pasur aktivitet investiv kanë investuar 20 mijë deri në një million DEM. Përkah vëllimi i mjeteve të investuara dallohet industria e gomes, pastaj e materialit ndërtimor dhe metalopërpunuese. Nga lëmitë tjera vëllim më të ndjeshëm të investimeve ka pasur transporti.

2. Investimet e Nevojshme për Konsolidimin e Prodhimit

Gati të gjitha ndërmarrjet e anketuara kanë deklaruar se për ristartimin dhe konsolidimin e prodhimit kanë nevojë për mjete të konsiderueshme investive. Vetëm 13 ndërmarrje të anketuara nuk kanë deklaruar se kanë nevojë për mjete investive. Shuma e mjeteve të nevojshme investive për ristartimin e prodhimit është mbi njëzet here më e madhe se sa shuma e mjeteve të investuara në periudhën e gjertanishme.

Investimet e Nevojshme për Ristartimin dhe rehabilitimin e procesit të prodhimit

Nr	Emërtimi	Shuma	Nr.i ndërmarrjeve	%
1	Pajisje	503,959,094	173	30
2	Mjetet xhiruese	253,349,931	165	29
3	Për pregaditjen e projekteve	9,993,208	118	21
4	Personeli	18,018,800	116	20
	Gjithsej	785,321,033	-	100

Nga shuma e gjithëmbarshme e mjeteve të nevojshme investive 64.2% do të destinoheshin për pajisje, 32.2% për mjete të xhiros dhe të tjerat për personelin dhe përgatitjen e projekteve. Mbi 2/3 e ndërmarrjeve kanë nevojë për investime në shuma relativisht të mëdha të cilat sillen prej 500 mijë deri në 10 milion DEM.

Vetëm tri degë të industrisë (agroindustria, ind. metalopërpunuese dhe e materialit ndërtimor) kanë kërkesë për mbi 53% të mjeteve të nevojshme investive. Për shuma relativisht të mëdha mjetesh investive kanë nevojë edhe tregëtia dhe transporti. Kërkesat individuale më të mëdha për mjete investive i kanë dy ndërmarrje që merren me xehetari.

3. Burimet e Pritura të Investimeve

Mjetet e nevojshme për investime mendohet të sigurohen nga këto burime.

Nr.	Emërtimi	Mesat. e %
1	Burimet e brendshme	24
2	Kreditë	34
3	Investimet e përbashkëta	22
4	Donacionet	21
	Gjithsej	100

Sigurimi i mjeteve nga këto burime është i vështirë për shumë arsye. Së pari, ndërmarrjet shoqërore pritët të transformohen. Derisa të bëhet transformimi i tyre donatorët dhe investitorët nuk janë të interesuar të hyjnë në investime për shkak se mungon infrastruktura ligjore me të cilën rregullohen raportet në investime të përbashkëta si dhe relacionet tjera në procesin e afarizmit. Vetë procesi i transformimit të pronës është ende në fazën e parapërgatitjes.

Investitorët e mundshëm të huaj të cilët kishin me kreditue ose me investime të përbashkëta për të mbështetur ristartimin dhe konsolidimin e prodhimit në ndërmarrjet shoqërore nuk janë të gatshëm të iu hyjnë këtyre aranzhmaneve për

arsye të mungesës së sigurisë, mungesës së infrastrukturës ligjore si dhe hamendjes së faktorit ndërkombëtar i cili ushtron funksionin e pushtetit në Kosovë për fillimin e procesit të privatizimit.

Mungesa e institucioneve financiare e veçanërisht e bankave bënë të pamundur realizimin e kredive dhe formave tjera të bashkëpunimit në lëminë e investimeve, edhe pse tash për tash kapitali i paktë financiar i vendit nuk është i gatshëm të angazhohet në sektorin shoqëror derisa të mos definohet e ardhmja e tij.

Burimet e mundëshme të investimeve të deklaruar në anketë nga ana e përgjegjësve janë më tepër tentim për gjetje rrugësh e mënyrash për të riaktivizuar kapacitetet ekzistuese dhe në këtë mënyrë për të zbutë sadopak problemet ekonomike e sociale të vendit. Është me rëndësi gjithashtu se rreth 80% e ndërmarrësve janë të interesuar për tu kyqur në procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore (anketa me 300 ndërmarrjet private).

Pjesa III

Transformimi i Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë

(1) AKTIVITETET LIDHUR ME TRANSFORMIMIN E NDËRMARRJEVE SHOQËRORE

Pas përfundimit të luftës e në mbështetje të Rezolutës 1244(1999) të Këshillit të Sigurimit të OKB në Kosovë u vendos administrimi i përkohshëm ndërkombëtar. Administrata e përkohshme ndërkombëtare kishte për detyrë që të sigurojë administrim kalimtar gjersa të themelon dhe mbikqyrë zhvillimin e institucioneve të përkohshme demokratike vërtetëqeverisëse për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e Kosovës. Edhe pse në shumë pjesë të sajë kjo Rezolutë mundë të quhet jo e plotë dhe shpeshher nuk i definon plotësisht autorizimet dhe fushveprimin e administratës së përkohshme ndërkombëtare në Kosovë, konsiderohet se ajo ka rëndësi dhe mundëson zhvillimin e aktiviteteve për ndërtimin e institucioneve të ekonomisë së tregut.

Ndër problemet e para me të cilat u ballafaqua administrata ndërkombëtare ishte ajo se cili është ligji i zbatueshëm në Kosovë. Me nxjerrjen e Regulloreve 1/99 dhe 24/99 kjo dilemë u tejkalua dhe u vendos që ligji i zbatueshëm në Kosovë është ai që ka qenë në fuqi para datës 22 Mars të vitit 1989. Ky qëndrim mbi ligjin e zbatueshëm në Kosovë, i shpehur përmes këtyre Regulloreve, ka efektet e tija edhe në sferën ekonomike dhe të pronsisë në teritorin e Kosovës.

UNMIK-u, konkretisht shtylla e IV e tijë, që në fillim të aktivitetit të tijë u gjet në vështërsi të shumta lidhur me realizimin e funksionit të tijë të përcaktuar me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit. Përkundër faktit që u nxorr Regullorja 14/1999 shumë shpejt u konstatua se sa i përket sferës ekonomike, shumë pak nga këto ligje, në mos asnjë, nuk mundë të aplikoheshin dhe nuk ishin të përshtatshëm për ekonominë e tregut të cilën UNMIK-u dhe shqiptarët dëshirojnë ta ndërtojnë në Kosovë.

Fillimi i krijimit të kornizës ligjore, përmes nxjerrjes së disa Regulloreve nga lëmija ekonomike, shihet si fillim i mirë për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin e mirëfillt të ekonomisë së tregut dhe të ndërtimit të strukturave të reja ekonomike. Problemi i veçantë me të cilin u ballafaqua administrata ndërkombëtare që në fillim, dhe ai qëndron edhe sot, është çështja e pronës shoqërore përkatësisht ndërmarrjet në pronsi shoqërore dhe aktivizimi i tyre. Fillimisht kishte pakjartësi tek ndërkombëtarët se cili është karakteri i kësaj prone, kush është pronari i vërtetë dhe athua prona shoqërore mundë të identifikohet me pronën shtetërore. Kjo krijoi një hezitim në veprim kështu që UNMIK-u nuk u mor me përkufizimin e mënyrës së qeverisjes së ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë por ato u administruan dhe në numrin më të madh edhe sot administrohen nga strukturat menagjeriale vendore të

cilat në rastet më të shpeshta nuk kanë të legalizuar bordin menagjerial nga ana e UNMIK-ut. Kjo u reflektua negativisht në procesin e rimëkëmbjes dhe nivelin e riaktivizimit të ndërmarjeve shoqërore si dhe në ecjen përpara në transformimin e përgjithshëm të shoqërisë kosovare.

Pas një kohe të gjatë hezitimi dhe konfuzioni lidhur me mundësinë e administrimit dhe të mënyrës së transformimit të pronës shoqërore UNMIK-u, shtylla e IV e tijë, kah maji i vitit 2000 bëri publik dokumentin me titull "Strategjia e Zhvillimit të Ndërmarjeve" apo si është quajtur "LETRA E BARDHË". Letra e bardhë, me disa vrejte që nuk kishin të bënin me përcaktimet e saja strategjike për të filluar me privatizimin e pronës shoqërore, u përkrah nga opinioni profesional, shoqëria civile dhe komuniteti i biznesit në Kosovë. Në të vërtetë fitohej përshtypja se për herë të parë pas vendosjes së administrimit të përkohshëm ndërkombëtar në Kosovë po bëhej një depërtim qensor në drejtim të fillimit të rimëkëmbjes dhe rikativizimit të ndërmarjeve ekonomike si dhe transformimit të pronës e cila është bosht kryesor dhe elementi më qensor në procesin e tranzicionit në një vend.

Letra e Bardhë kishte përpunuar përparsit e këtij koncepti, definimin e të drejtës pronsore, kompletimin e kornizës ligjore, strategjinë për ndërmarjet jo private (shoqërore) si dhe mënyrën e ndërtimit të konsenzuesit social. Krejt këto ishin shtruar si politika që duhej të ndiqeshin për tu realizuar kjo strategji.

Në Letrën e Bardhë çështja e pronsisë së ndërmarjeve shoqërore shtrohet si ende e pakjart. Përkundër faktit që konstatohet se me nxjerrjen e Regullores 24/1999, sipas ligjeve të aplikueshme, ndërmarjet duhet të kishin qenë në tërësi në pronsin shoqërore, përveq një numri të papërfillshëm që u privatizuan sipas ligjit "Markoviq", prapëseprap merreshin në konsideratë, si fakt, transformimet pronsore që janë bërë nën pushtetin serb në dhjetëvjetshin e fundit. Duke u nisur nga ky kandvështrim dhe nga fakti që, sipas UNMIK-ut aktualisht nuk ka mekanizëm për kuartësimin e këtyre çështjeve, në Letrën e Bardhë propozohet formimi i një Komisioni Gjykimi (KGP), si trup ad hoc, i cili për çdo ndërmarje do të merrte vendime mbi strukturën e pronsisë dhe do të vendoste për pretendimet pronsore.

Letra e Bardhë, ndër të tjera shtrinë nevojën e krijimit të Agjensisë për Privatizim të Kosovës (APK), në vartësi të të cilës do të ishin bizneset që shumicën e akcioneve do ta kishin pronë publike. Nxjerja e një paketi ligjesh me të cilat do të krijohet korniza ligjore për transformime pronsore dhe krijimin e kushteve për zhvillimin e ekonomisë së tregut mirren si qështje me përparësi dhe të një rëndësie të veçantë. Letra e bardhë shtrinë edhe bazat e strategjisë së menagjimit të ndërmarjeve gjat procesit të privatizimit dhe përgjegjësitë e bordeve menagjeriale për këtë kohë.

Sado që Letra e Bardhë u duk si një fillim i ecjes më të shpejtë dhe më cilësore në drejtim të transformimit pronësor dhe me këtë vendosjen e rrjedhave ekonomike në binarët e ekonomisë së tregur ajo si duket nuk filloi të zbatohet sipas dinamikës së propozuar. Ka zëra se kjo ka ndodhur nga shkaku i pengesave të natyrës politike në nivel të Këshillit të Sigurimit të OKB. Ka shumë informacione dhe elemente që qojnë në përfundim se UNMIK-u, në mungesë të një qëndrimi unik politik, në nivel të KS të OKB, rreth fillimit të procesit të transformimit pronësor, të ketë hequr dorë nga strategjia e propozuar e Letrës së Bardhë, apo prej pjesës më të madhe dhe më qenësore të sajë. Mund të thuhet se tani për tani UNMIK-u ka për qëllim strategjik parsor komercializimin dhe jo privatizimin, e që mund të mirret si një mungesë serioze në procesin e transformimit dhe demokratizimit në Kosovë.

Në raportin e Bankës Botërore të datës 30 Qershor 2000 vërehet një çasje më e avancuar dhe më e çartë, se ajo në Letrën e Bardhë, sa i përket procesit të transformimit pronësor në Kosovë. Edhe pse si bazë për shqyrtimin e çështjes së privatizimit Banka Botërore ka për pikënisje përcaktimet strategjike dhe politikat që duhet ndjekur, të parashtruara në letrën e Bardhë, rekomandimet e propozuara nga ajo përmbajnë një argumentim më të fuqishëm dhe më cilësor për nevojën e privatizimit të ndërmarjeve shoqërore. Ajo rekomandon institucionet, procedurat dhe mekanizmat që duhet ti ndjekin ato si dhe propozon modelet e mundëshme të privatizimit. Çasja e Bankës Botërore mund të jetë influencuar nga përvoja e sajë që ka në vendet në tranzicion.

Vlen të veçohet se Banka Botërore në materialin e sajë bëri klasifikimin e ndërmarjeve që janë në prorsinë shoqërore e të cilat janë të planifikuara për privatizim. Ajo këto ndërmarje i klasifikon në këto kategori:

1. Ndërmarrje shumë të mëdha dhe unike si kompleksi minerar i Trepçës;
2. Ndërmarrjet komunale;
3. Ndërmarrjet për të cilat mund të egzistojë interes potencial në radhët e investitorve të huaj;
4. Ndërmarrje të tjera, me levërdi të çartë ose me levërdi potenciale; ndërmarjet pa kurrfarë leverdie.

Gjithashtu, në material Banka Botërore propozon metodat e privatizimit të cilat sipas sajë mundë të jenë të përshtatëshme në rastin e Kosovës. Këto do të ishin:

1. Shitja apo likuidimi i pasurive të ndërmarjeve pa levërdi ekonomike;
2. Ankande publike dhe tendera për akcionet e shumicës së ndërmarjeve me levërdi ekonomike;
3. Konçesione ose kontrata administrimi për raste të veçanëta si Trepça.

Sido që të jëtë koncepti i Bankës Botërore, përkundër përvojës së sajë me situata të ngjashme në vendet në tranzicion, duhet të pasurohet edhe me specifikat kosovare në mënyrë që të arrijë sukses të plotë.

Në kuadër të kompetencave të veta edhe Departmenti i Industrisë dhe Tregtisë (DTI), ndër të tjera, është i involvuar edhe në të gjitha aktivitetet që përmenden në Letrën e Bardhë. Ky department përgaditi dhe realizoi tenderin e parë për dhënjën me qira të fabrikës së çimentos "SHARR" në Han të Elezit dhe së fundi edhe të Ndërmarrjes Mirusha të Klinës. Janë shpallur edhe disa tendere të tjera për komercializim. Aktualisht ai po punon në përgaditjen e disa Rregulloreve komerciale (ekonomike). Këto kryesisht janë:

1. Rregullorja për Shoqëritë Tregtare (ka për qëllim definimin e tipeve të ndryshme të ndërmarrjeve private dhe krijimin e parimeve për qeverisjen e korporatave). Kjo Rregullore është aprovuar nga KPA;
2. Rregullorja për Pengun mbi Pasurinë e Luajtshme (ka për qëllim sigurimin e transaksioneve dhe krijimi i regjistrit për pronë). Është aprovuar në KPA;
3. Rregullorja për Investimet e Huaja (të ndihmojë/krijojë kushte për investime të huaja në Kosovë). Është aprovuar në KPA
4. Rregullorja për Kontratat e Shitjen së Mallrave (miratimi I Konventës së Vjenës për shitje, si Ligj Kosovar). (Reg.Nr.68/00 është miratuar me 29.12.00);
5. Rregullorja mbi Bankrotin/Falimentimin (likuidimi apo riorganizimi i ndërmarrjeve të pa afta për pagimin e borjeve). Drafti është në përgaditje në DTI. Rregullorja mbi Kontabilitetin. (Drafti është në përgaditje në DTI), etj.

Karakteristikë për të gjitha këto rregullore është se në to janë inkorporuar, varësisht nga objekti i rregullimit të tyre, parimet dhe kriteret e parashikuara në Letrën e Bardhë dhe zgjidhjet e tyre mbështeten në standardet perëndimore.

DTI aktualisht është i preokupuar me aktivitetet rreth shpalljes së tendereve për dhënjë me qëra të afërsisht 20 ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë.

Gjithashtu, kah gjysma e dhjetorit të vitit 2000, DTI përpiloi një Letër rekomandimi të cilën ia drejtoi shtyllës së IV të UNMIK-ut. Kjo letër kishte të bënte me një strategji të re të mundëshme për transformimin e ndërmarrjeve shoqërore në Joint Stock Companies (shoqëri akcionare). Për kornizë ligjore për të bërë transformimin pronar të ndërmarrjeve shoqërore propozohet të jenë ligjet e viteve 1988/90 (ligji i Markoviqit). Rekomandimi përfshin obligimet dhe aktivitetet e UNMIK-ut, Shtyllës së IV të tij, DTI dhe elementeve të tjera të cilët do të involvoheshin në këtë proces.

Ne mendojme se kjo iniciative dhe strategji duhet të mbështetet në parim si njëra ndër format e fillimit të procesit të transformimit të pronës shoqërore në Kosovë. Me këtë do të mundësohej që procesi i privatizimit të fillojë dhe që komercializimi të shmanget si formë e vetme e revitalizimit të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore dhe

se ai do të përkufizohet në funksionin dhe efektet që ka patur në vendet tjera në tranzicion. Edhe pse ende nuk jemi të sigurt se a do të adoptohet kjo strategji nga ana e UNMIK-ut e shohim të nevojshme të tërheqim vëmendjen për sa vëlon :

Rethanat e sotme shoqërore dhe ekonomike si dhe synimet e shoqërisë Kosovare në këto fushë nuk janë të njëjta me ato të cilat ishin në kohën kur u nxorën ligjet të cilat propozohen që të jenë bazë për transformimin pronësorë të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore;

- Mundë të ketë efekte destimulative nëse kufizohet mundësia që kapitali i huaj mund të blejë vetëm 30% të akcioneve të këtyre ndërmarrjeve. Kjo do të shprehet negativisht në regjenerimin e tyre;
- Në mungesë të tregut financiar akcionet do të jenë të shpërndara në më shumë pronarë dhe kjo mund të ketë efekte negative në qeverisjen e ndërmarrjeve;
- Ka edhe shkaqe të tjera të cilat shtojnë nevojën që kjo strategji të adoptojë parimet bazë dhe zgjidhet të cilat janë treguar të efektshme në procesin e privatizimit në vendet në tranzicion.

(2) QËNDRIMET E KOMUNITETIT TË BIZNESIT

Riinvesti është në realizim e sipër të Projektit me titull "Promovimi i Zhvillimit Ekonomik Nëpërmes Shoqërisë Civile" i cili është i mbështetur nga zyra e USAID-it në Prishtinë dhe CIPE në Vashington. Qëllim i këtij Projekti, ndër të tjera, është edhe hartimi i Strategjisë së Privatizimit në Kosovë. Gjatë vitit 2000 dhe në janar të 2001 u zhvilluan disa aktivitete të këtij Projekti me qëllim të përpunimit të kësaj Strategjie dhe këto kryesisht janë:

- Tryeza e diskutimeve rreth Letrës së Bardhë, në bashkëpunim me KACI-n;
- Konstituimi i Bordit Këshilldhënës të RIINVEST-it për Biznis;
- Organizimi I takimeve me komunitetin e biznesit në 7 qendrat rajonale në Kosovë;
- Anketimi i 192 Ndërmarrjeve Shoqërore;
- Anketimi i 300 Ndërmarrjeve private;
- Organizimi I dy tryezave të rrumbullakta joformale me ekspert vendor dhe të huaj;
- Inicimi dhe organizimi i takimeve punuese me përfaqësuesit e UMIK-ut, shtyllës së IV të tijë, DTI, Bankës Botrore, Agjensisë Evropiane për Rindërtim, Odës Ekonomike të Kosovës etj. me qëllim të këmbimit të përvojave, informacioneve si dhe të advokimit të qëndrimeve dhe pikpamjeve të Riinvestit lidhur me me shumë çështje aktuale e në veçanti lidhur me fillimin e procesit të Privatizimit në Kosovë;

- Hulumtimi i përvojave relevante për Kosovën lidhur me privatizimin;
- Përgaditja e Konferencës Ndërkombëtare lidhur me strategjinë e privatizimit në Kosovë.

Anketa e Riinvestit, e cila është prezentuar në këtë raport, tregon një disponim pozitiv për privatizim. Nga rezultatet e anketës del se 83,5% (ndërtimtari, material ndërtimor, industria kimike, përpunimi i drurit, shërbimet, tregtia, industria metalopërpunuese, paisjet elektrike) të ndërmarrjeve të anketuara mendojnë se privatizimi duhet të fillojë menjëher dhe se është e vetmja alternativë. Vetëm 10,7% e ndërmarrjeve të anketuara nuk janë për privatizim. Ndërsa 10% të udhëheqësve të anketuar nuk kanë mendim për privatizimin.


Anketa e sipërpërmendur tregon se ndërmarrsit kanë mendim të ndarë rreth komercializimit. Një pjesë e tyre, në anketën me 192 ndërmarrje shoqërore, 53% mendojnë se është një formë e mirë për riaktivizimin e ndërmarrjeve të tyre në mungesë të mundësive të tjera, 31% janë kundër dhënjes me qëra, 20% e përkrahin dhënjen me qëra vetëm në mungesë të ligjit mbi privatizimin, përkatsisht vetëm nëse pamundësohet privatizimi. Ndërsa 14% prej tyre nuk kanë mendim për këtë.

Cili është mendimi juaj rreth transformimit të ndërmarrjeve shoqërore?

Përgjigjet	Nr.	%
Duhet të privatizohen menjëherë	100	79
Duhet të komercializohen ose jepen me qira	17	13
Duhet të konsolidohen si NSH	9	7
p.p	0	0
Gjithsej	126	100


Edhe rezultatet e anketës me 300 ndërmarrje private kanë përafërsisht tregues të njëjtë. Nga 300 ndërmarrje të anketuara 78% mendojnë se procesi i privatizimit duhet të fillojë menjëher. Vetëm 17% të të anketuarve janë për komercializim dhe 5% mendojnë se ndërmarrjet shoqërore duhen të konsolidohen kështu si janë. Të anketuarit, 65% kanë shprehur gadishmerinë të kyçen në privatizim, ndërsa 33% nuk e kanë shprehur këtë gadishmëri. Ata gjithashtu u deklaruan se do të blenin aksione 36%, do të merrnin me qëra 18%, do të blenin në tërësi ndërmarrjen 12%, nuk kanë mundësi 13% dhe vetëm 7% nuk janë të interesuar.

Çfarë është gatishmëria e juaj për tu kyçur në privatizim?



Nga rezultatet e bisedave me komunitetin e biznesit në shtatë qendrat më të mëdha në Kosovë si dhe nga rezultatet e dy anketave del se privatizimi nuk ka alternativë dhe se ai duhet të fillojë sa më shpejt, dhe se ka mbështetje të fuqishme në komunitetin e biznesit dhe në opinionin kosovar në përgjithësi. Nga këto aktivitete në Riinvest janë kristalizuar disa qëndrime parimore lidhur me problemet që ndërlidhen me privatizimin e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë:

Nëse fillon privatizimi, ju jeni të gatshëm të....



Dilema rreth karakterit të pronës shoqërore dhe konkluzionet rreth ambiguitetit të saj në Kosovë, sikurse janë të dhëna në pjesën e parë të Letrës, nuk qëndrojnë. Pronësia shoqërore nuk ka qenë pengesë në procesin e privatizimit në asnjërën njësi të ish Jugosllavisë. Në këtë aspekt kompetencat kushtetuese të Kosovës kanë qenë të njëjta me njësitë tjera federale. Situata e krijuar nga qeveria serbe pas vitit 1989 ka qenë ilegale dhe rezultat i dhunës, kështuqë ajo gjendje nuk mund të merret në konsiderim. Nuk ka nevojë të ngriten dilema në rastin e Kosovës në lidhje me atë se “kujt i takon prona shoqërore në Kosovë”, sepse kjo është a panevojshme dhe kjo mund të krijojë paqartësi dhe rezistencë nga faktori ndërkombëtar (UN) dhe nga të tjerët rreth fillimit të procesit të privatizimit në Kosovë, dhe gjithashtu diskurajimin e investitorëve të huaj të investojnë në Kosovë. Kjo mund të ketë edhe pasoja negative në rindërtimin ekonomik në Kosovë dhe në disponimin e popullsisë Kosovare. Të kontestosh fillimin e privatizimit do të thotë të hysh në një terren të ndieshëm mbi të drejtën e qeverisjes së pronës shoqërore në Kosovë të cilën burimisht e ka dhe e ka pasë Kosova.

(3) OPCIONET DHE KRITERET E PRIVATIZIMIT

Deri më sot janë adresuar opsione të ndryshme për rehabilitimin dhe transformimin e ndërmarrjeve shoqërore:

- A). Komercializimi
- B). Shëndrrimi në Shoqëri Aksionare me shumicën e aksioneve për punëtorët
- C). Privatizimi përmes metodave tjera duke ndjekur përvojat e përparuara të vedneve tjera në tranzicion

Ne konsiderojmë se zgjidhja e dilemave të tanishme duhet të bazohet në dilemat si vijon:

- (1) Ndikimi në procesin e reformave, ndërtimin e ekonomisë së tregut dhe institucioneve demokratike
- (2) Efikasiteti dhe efektiviteti ekonomik
- (3) Joshja e drejtpërdrejtë e investimeve private të vendit dhe ato të huaja

Komercializimi nuk mund të jetë zëvendësim për privatizimin as e vetmja metodë që implementohet. Ai mund të jetë si një nga metodat për riaktivizimin e ndërmarrjeve shoqërore por duke e vënë në korniza reale, duke u bazuar në përvojat e vendeve të tjera ku komercializimi ka qenë instrument parapërgaditës për privatizim për një periudhë më të shkurtër rreth 3 vite. Ndërsaq periudha afatgjatë (10 vjeçare siç praktikohet në Kosovë) e dhënjes me qira (e komercializimit) do të mundë të arsyetohej vetëm në rast se për ndërmarrjen e caktuar nuk ka të interesuar për privatizim. Efektet financiare të komercializimit në krahasim me privatizimin janë shumë më të vogla, nëse kihet parasysh vlera e tanishme e fondit që mundë të krijohet me privatizim dhe vlerën e tanishme të qerasë që do të grumbullohet gjatë 10 vjetve të ardhshme. Gjithashtu komercializimi (dhënja me qira) mund të shfaqet si një hendikep për privatizim gjatë periudhës sa zgjatë kontrata, ndonse kjo nuk prijashtohet. Objektivisht disponuesi i kontratës për qira do të jetë në përparësi në krahasim me të tjerët në procesin eventual të privatizimit.

QËNDRIMET E KOMUNITETIT TË BIZNESIT MBI PRIVATIZIMIN

**83.5% E MENAXHERËVE TË NDËRMARRJEVE SHOQËRORE E PËRKRAHIN PRIVATIZIMIN
53% DO TA PRANONIN KOMERCIALIZIMIN NËSE NUK EKZISTON ALTERNATIVË TJETËR**

Sa i përket opcionit për transformim në shoqëri aksionare ku pjesën më të madhe të pronës do ta zotëronin punëtorët, problemi kryesor qëndron në efikasitetin ekonomik dhe dyshimin rreth inkurajimit të investitorëve privat të huaj dhe të vendit. Procesi i privatizimit duhet të shpejtohet sepse çdo vonim në implementimin e tij do të ketë konsekuenca sociale si dhe në përkeqësimin e situatës në ndërmarrjet shoqërore. Fondet e krijuara nga privatizimi i ndërmarrjeve shoqërore duhet të jenë në funksion të zhvillimit të fondeve për bizneset e vogla, infrastrukturën, dhe konsolidimin financiarë. Ekziston një konsensus se dedikimi i këtyre fondeve nuk duhet të bëhet për shpenzime buxhetore.

Përvojat nga vendet tjera në tranzicion sugjerojnë se për ta siguruar një qverisje të drejtë dhe të mirë me procesin e privatizimit, nevojitet një strategji e qëndrueshme e privatizimit. Mungesa e një strategjie të mirëfilltë është shfaqur si pengesë në shumicën e vendeve në tranzicion, e cila ka shkaktuar ndryshimin e shpeshtë të metodave, formave të qeverisjes me privatizimin, dhe kornizës ligjore dhe institucionale. Në shumicën e rasteve, mungesa e transparencës dhe prezencës

korupcionit e kanë përcjellur procesin e përgjithshëm. Kosova mund të mësojë shumë nga përvojat e suksesshme dhe të pasuksesshme të këtyre vendeve, dhe ta zhvillojë strategjinë e saj të qëndrueshme. Raporti mbi përvojat relevante ndërkombëtare I zhvilluar nga Profesor Iraj Hashi, së bashku me këtë raport krijojnë një bazë solide dhe përfaqësojnë hapat e parë për zhvillimin e mëtejshëm të strategjisë së privatizimit.

PRIVATIZIMI NDAJ KONVERZIONIT (SHËNDRRIMIT) DHE KOMERCIALIZIMIT

- Ndikimet në proceset e reformave, ekonomisë së tregut, institucioneve demokratike
- Efikasiteti dhe efektiviteti
- Zhvillimet financiare – inkurajimi i investitorëve privat të vendit dhe të huaj

Ne rekomandojmë:

- Privatizimin përmes metodave dhe modeleve që janë vërtetuar si më të suksesshmet
- Zhvillimin e një Strategjie të Qëndrueshme të Privatizimit (duke përfshirë kornizën ligjore
- Përfshirjen e partive politike dhe shoqërisë civile në diskutime

Duke e marrë parasysh rëndësinë e çështjes së transformimit pronësorë dhe privatizimit, shihet nevoja për një involvim më të madh të partive politike kryesore, komunitetit të OJQ-ve, dhe mediave në këtë proces. Deri më tani kjo nuk ka qenë praktikë. Do të ishte e rëndësishme që ky diskutim të fokusohet në çështjet që kanë të bëjnë me privatizimin efikas dhe të drejtë I cili përfshinë transparencën dhe mënjanimin e panevojshëm të polarizimeve politike rreth çështjeve pronësore dhe mundësive për ta realizuar privatizimin efektiv në Kosovë. Për shkak të kësaj, do të ishte me rëndësi të presentohen argumentet e përgjithshme tek agjensitë e KB-ve me qëllim që të ofrohen metodat efikase për rimekëmbjen ekonomike të Kosovës, dhe për të siguruar efektin real të investimeve që komuniteti ndërkombëtar është duke i bërë këtu.

Aneksi I

Tabela 1. Pasqyrë e shkallës së aktivitetit ekonomik të ndërmarrjeve të anketuara në %

Nr	LËMIA	Nr. i Ndërmarrjeve	Ndërmarrje Aktive	Ndërmarrje Pasive	
A	Industria	118	84	16	100
<i>I</i>	Agroindustri	37	78	22	100
2	Metal përpunuese dhe pajisje elektrike	29	83	17	100
3	Material ndërtimor	15	73	27	100
4	Industria kimike, plasike dhe e letrës	12	83	17	100
5	Industri e tekstilit, lëkurës	11	91	9	100
6	Përpunim druri	6	100	-	100
7	Industria grafike	4	100	-	100
8	Industria e gomës	2	50	50	100
B	Ndërtimtari	14	86	14	100
C	Tregti	14	100	-	100
D	Bujqësi	13	92	8	100
E	Turizëm	12	92	8	100
F	Shërbime	10	100	-	100
G	Transport	9	89	11	100
H	Xehetari	2	50	50	100
I	Të tjera	2	100	-	100
	Gjithsej		87.5	12.5	100

Tabela 2. Shkalla e shfrytëzimit të kapaciteteve sipas lëmive ekonomike në (%).

Nr	LËMIA	1988	1989	1999	2000
A	Industria	70.9	71.7	28.6	32.6
<i>I</i>	Agroindustri	71.1	67.6	22.4	28.1
2	Metal përpunuese dhe pajisje elektrike	65.2	65.5	20.3	25.2
3	Material ndërtimor	76.0	78.5	39.5	51.1
4	Industria kimike, plasike dhe e letrës	61.7	65.9	35.7	28.5
5	Industri e tekstilit, lëkurës	86.7	80.4	16.4	14.9
6	Përpunim druri	65.0	57.3	34.7	44.0
7	Industria grafike	55.0	67.5	45.0	48.8
8	Industria e gomës	90.0	90.0	-	-
B	Ndërtimtari	90.4	85.3	31.4	40.6
C	Tregti	95.0	96.3	25.8	43.7
D	Bujqësi	77.5	66.0	24.3	33.9
E	Turizëm	94.6	83.8	34.6	34.0
F	Shërbime	100.0		21.0	57.5
G	Transport	84.5	75.5	44.6	54.1
H	Xehetari	67.0	72.5	15.0	20.0
I	Të tjera	80.0	80.0	29.0	25.0
	Gjithsejt	76.0	73.0	28.0	35.0

Tabele 3. Realizimi i përgjithshëm sipas sektorëve (DEM)

Nr.	Sektori	No. I ndërmarrjeve	1989	1999	2000	2000/1999
1	Industria	116	567,296	88,904	283,483	318.8
2	Ndërtimtaria	14	34,569	6,112	16,232	265.6
3	Tregtia	14	154,949	11,732	11,545	98.4
4	Bujqësia	13	25,789	2,897	1,601	55.3
5	Tourizmi	12	7,406	13,498	18,591	137.7
6	Shërbimet	10	12,277	1,116	4,464	400
7	Transporti	9	47,891	2,744	5,610	204.4
8	Xehetaria	2	—	1,050	1,550	147.6
9	Të tjerat	2	—	—	104	—
Gjithsej		192	850,177	128,053	349,180	272.7

Tabela 4. Kërkesat dhe Obligimet (DEM)

Nr.		Nr.i ndërmarrjeve	Nr.i ndërmarrjev që kanë kërkesa	Gjithsej kërkesa në DEM	Nr. i nderm. që kanë obligime	Gjithsej obligime në DEM
A	Industri	118	55	33,148,256	48	72,107,714
	1 Agroindustri	37	14	2,060,569	12	1,020,074
	2 Metal përpunuese dhe pajisje elektrike	29	16	26,623,865	12	26,346,882
	3 Material ndërtimor	15	7	1,075,588	6	571,208
	4 Industria kimike, plasike dhe e letrës	12	1	252,259	3	6,537,000
	5 Industri e tekstilit, lëkurës	11	9	2,452,900	7	36,719,569
	6 Përpunim druri	6	1	58,000	3	439,900
	7 Industria grafike	4	4	341,753	4	272,046
	8 Industria e gomës	2	2	283,322	1	201,035
B	Ndërtimtari	14	6	1,529,000	5	536,366
C	Tregti	14	5	460,006	4	882,793
D	Bujqësi	13	1	91,675	2	108,160
E	Turizëm	12	2	1,180,243	6	611,246
F	Shërbime	10	6	909,266	4	213,214
G	Transport	9	3	1,017,832	3	1,230,103
H	Xehetari	2	1	270,000	0	-
I	Të tjera	2	1	300,000	1	53,932
	Gjithsej	192	79	38,906,278	74	75,743,528

Tabela 5. Pasqyrë mbi disa grupe të rëndësishme eksportuese (mil. DEM)

Eksportuesit	Eksport i 1989	Investimet për riaktivizim dhe konsolidim	Stoqet	Dëmet
I. Akumulatorët :	61.7	12.1	2.1	10.9
(1). Mitrovica	37.3	4.8	0.4	4.8
(2). Peja (1988)	17.3	4.5	1.0	2.5
(3). Gjilani	17.1	2.8	0.7	3.6
II. Amortizerët	20.0	32.7	3.0	2.2
III. Feronikli	189.3	13.0	-	45.0
IV. Ballkani (goma)	23.0	10.9	9.5	10.0
V. Auto pjesët, Pejë	18.8	0.5	1.1	14.8
VI. Elektromotorët	40.0	3.0	2.0	0.8
VII. Famipa Prizren	1.1	3.0	0.9	2.5
VIII. Tekstili, këpucet dhe galanteria	23.6	24.4	8.6	15.7
IX. Venaria	16.7	18.7	14.4	7.0
Gjithsej	394.2	118.3	41.6	108.9

Tabela 6. Struktura kualifikuese e të punësuarve sipas lëmive në%

Nr.	Emërtimi	Nr. i ndermarrjeve	Nr. i punëtorëve më 2000	Me fakultet	Me shkollë të lartë	Me shkollë të mesme	Me shkollë fillore	Pa kualifikim
A	Industri	116	29,414	6.0%	7.3%	48.5%	29.6%	8.7%
1	Agroindustri	37	5,163	7.6	10.3	42.2	28.8	11.4
2	Metal përp. dhe pajisje elektrike	29	8,461	6.5	6.2	58.5	23.2	5.6
3	Material ndërtimor	15	4,291	4.5	2.9	41.7	43.5	7.3
4	Industria kimike, plasike dhe e letrës	12	1,745	5.5	3.5	49.5	30.6	10.8
5	Industri e tekstilit, lëkurës	11	6,609	4.0	6.8	44.8	31.1	13.3
6	Përpunim druri	6	1,437	2.8	5.1	32.4	49.4	10.2
7	Industria grafike	4	402	2.7	3.2	47.6	40.8	5.6
8	Industria e gomës	2	1,332	7.6	2.4	82.3	7.0	0.8
B	Ndërtimtaria	14	2,793	4.1	3.0	38.2	42.8	11.9
C	Tregti	14	2,878	4.4	3.2	78.9	9.5	4.1
D	Bujqësi	13	1,192	4.6	2.9	31.5	37.7	23.3
E	Turizëm	12	1,458	4.2	2.9	73.5	13.4	6.1
F	Shërbime	10	1,167	4.4	4.7	28.8	32.8	29.3
G	Transport	9	2,585	3.2	3.8	77.3	11.6	4.1
H	Të tjara	4	1068	10.3	14.1	38.	35	2.3
	Gjithsej	192	42,581	5.0	5.0	51.0	28.0	9.0

Tabela 7. Pasqyrë e struktures së kapitalit fiks të ndërmarrjeve shoqërore (në 000 DEM)

Nr.	Sektori	Nr. i nder.	Paisje	Objekte	Tokë	Gjithësej	Përqindja e amortizimit
1	Industria	116	1,165,754	1,145,272	335,363	2,646,389	66.1
2	Ndërtimtaria	14	55,452	164,076	55,439	274,967	66.1
3	Tregtia	14	40,050	391,044	18,466	449,560	35.6
4	Bujqësia	13	24,037	60,195	344,396	428,628	76.5
5	Turizmi	12	39,356	169,670	25,707	234,733	51.7
6	Shërbimet	10	24,434	18,842	1,426	44,703	50.0
7	Transporti	9	61,238	39,746	15,382	116,366	55.9
8	Të tjera	4	166,400	33,229	70,200	269,829	68.3
	Gjithsejt	192	1.576.721	2.022.074	866.378	4.465.173	60.7

Tabela 8. Struktura e kapitalit të ndërmarrjeve të Industrisë (në 000 DEM)

Nr.	Degët e industries	Nr. i nderm	Pajisje	Objekte	Tokë	Gjithsej	Amortizimi mesatar
A	Industri	116	1.165.754	1,145,272	335,	2,646,389,	66,1
1	Agroindustri	37	204,222	243,946	159,536	607,704	53.0%
2	Metal përp. dhe pajisje elektrike	29	434,338	261,878	21,662	717,878	60.9%
3	Material ndërtimor	15	136,759	130,0322	70,131	336,922	48.8%
4	Ind. Kim. plasike dhe e letrës	12	79,148	84,753	8,015	171,915	54.3%
5	Industri e tekstitit, lëkurës	11	127,170	159,319	31,014	317,502	41.9%
6	Përpunim druri	6	90,359	116,742	43,504	250,605	60.5%
7	Industria grafike	4	35,177	53,497	0	88,674	45.2%
8	Industria e gomës	2	58,581	95,105	1,500	155,187	48.0%

Tabela 9. Struktura e burimit të investimeve (në 000 DEM)

J		Nr. i nderm	Nr. i nder. që kanë pasur investime	1.Dona- cione	2. Kredi	3. Të tjera	Gjithsej investime (1+2+3)	Mesatarja për një ndërmarrje
Nr								
A	Industri	118	47	4.758	8.926	12.420	26.105	555
1	Agroindustri	37	11	720	269	2,451	3,441	312
2	Metal përpunuese dhe pajisje elektrike	29	13	308	50	4,397	4,755	366
3	Material ndërtimor	15	6	3,480	50	1,950	5,480	913
4	Industria kimike, plasike dhe e letrës	12	3	-	28	90	118	39
5	Industri e tekstilit, lëkurës	11	7	250	250	1,177	1,677	240
6	Përpunim druri	6	2	-	25	265	290	145
7	Industria grafike	4	2	-	-	90	90	45
8	Industria e gomës	2	1		8,254		8,254	8,254
B	Ndërtimtari	14	9	-	350	620	970	108
C	Tregti	14	5	-	400	901	1,301	260
D	Bujqësi	13	6	309	-	344	653	109
H	Turizëm	12	7	568	90	798	1,456	208
I	Shërbime	10	4	242	-	1,450	1,692	423
J	Transport	9	6	4,171	1,060	1,221	6,452	1,075
K	Të tjera	4	2	-	-	2,000	2,000	1,000
	Gjithsej	192	84	10,048,	10,826	17,754	38,628	460

PROJEKTI:

BAZA E TË DHËNAVE PËR NDËRMARRJET SHOQËRORE

Nr. i ndërmarrjes: _____

Data e anketimit: _____

Anketuesi: _____	Kontrolli në terren: Po	Jo
	Kontrolli logjik: Po	Jo

Ky anketim zhvillohet nga ana e Institutit RIINVEST me qëllim të krijimit të bazës së të dhënave për ndërmarrjet shoqërore në Kosovë.

Informatat e fituara nga ky anketim do të trajtohen si informata interne dhe do të shfrytëzohen nga ana e Institutit me qëllim të propozimit të rekomandimeve për transformimin dhe aktivizimin e këtyre ndërmarrjeve.

Instituti RIINVEST Ju falendëron për gadishmërinë e Juaj për bashkëpunim.

A. TË DHËNA TË PËRGJITHSHME PËR NDËRMARRJEN
--

1. Emri i ndërmarrjes _____
2. Ndërmarrja është: - aktive
 - jo aktive
3. Vendi _____
4. Veprimtaria:

a) Industri

1. Agroindustri (ushqimore, e pijeve etj)
2. Tekstil, lëkurë
3. Përpunim druri
4. Plastik
5. Industria kimike
6. Metal perpunuese
7. E letres
8. Pajisje elektrike
9. Të tjera

b) Shrëbime

1. Inxhiniering
2. Shtypje / publikim
3. Shërbime tjera

c) Ndërtimtari

d) Tregti

e) Transport

f) Hoteleri, restaurante dhe turizëm

g) Tjetër, cila _____

B. TË DHËNA PËR VEPRIMTARINË

		1988	1989	1999	Deri më 31, gusht 2000
I.	Prodhimi (vëllimi, në njësi fizike, tre artikujt më kryesorë) a) b) c)				
II.	Shfrytëzimi i kapaciteteve në %				
III.	Të ardhurat në DM 1. Të ardhurat e përgjithshme (Realizimi) 2. Shpenzimet 4. Të ardhurat personale 5. Fitimi / humbja				
IV.	Shitja në DM sipas rajoneve: 1. Tregu i brendshëm (Kosovë) 2. Tregu në ish Jugosllavi 3. Tregu i jashtëm GJITHSEJ				

		1989	1999	2000
V.	A. Personeli (të gjithë punëtorët) gjithsej:			
	B. Ku gjenden tani punëtorët a) Në Kosovë b) Jashtë Kosove			
	C. Aktivizimi i punëtorëve: a) Punëtorë aktivë b) Punëtorë që marrin pagë në shtëpi c) Punëtorë që nuk paguhen			

	D. Kualifikimi i punëtorëve (për të gjithë punëtorët): a) Me fakultet b) Me shkollë të lartë c) Me shkollë të mesme d) Me shkollë fillore e) Pa kualifikim	
		2000
VI.	Stafi udhëheqës (sipas kualifikimit) a) superior b) i lartë c) i mesëm d) të tjerë	
VII.	Mosha e të gjithë të punësuarve (sipas grupmoshave): a) 20 – 30 b) 30 – 40 c) 40 – 55 d) 55 –	
VIII.	Teknologjia A. Vlera e kapitalit fiks (mjetet themelore) në DM: 1. Toka 2. Objekte 3. Pajisje B. Amortizimi i pajisjeve në %	
IX	Vlera e dëmtimeve në DM (të evidentuara pas luftës): a) Ndërtesa dhe objekte tjera b) Pajisjet c) Të tjera	
X.	KËRKESAT DHE OBLIGIMET A) Kërkesat gjithsej në DM -Kërkesat (DEM) sipas partnerëve (3 partnerët kryesore): 1) 2) 3)	

	B) Obligimet gjithsej në DM ndaj kredive dhe partnerëve afaristë: -Tre partnerët kryesore ndaj të cilëve keni obligime: 1) 2) 3)	
XI.	STOQET A) Material dhe dhe të lendëve të para në vlerë (DEM) B) Stoqet në produkte të gatshme	
	C) Kapitali financiar me të cilin disponohet (DEM) 1) Kesh 2) Xhirollogari 3) Kredi e siguruar	

XII. BURIMET E INVESTIMEVE TË GJERTANISHME:

1. Donacione _____DM
2. Kredi _____DM
3. Të tjera _____DM

GJITHSEJ _____DM

XIII. INVESTIMET E NEVOJSHME PËR RISTARTIMIN DHE KONSOLIDIMIN E PRODHIMIT

A) Pajisje (përshkrimi çka) dhe vlera në DEM
_____DM

B) Mjetet xhiruese (kapital financiar, material në DEM)
_____DM

C) Për përgaditjen e Projektimve dhe studimeve për investime dhe tjera
_____DM

D) Personeli (nevojat, format dhe lëmia e aftesimit, trajnimi)

_____DM

Gjithsej INVESTIMET (A + B + C+ D)

_____DM

XIV. BURIMET E PRITURA TË INVESTIMEVE NË PËRQINDJE (%)

- | | |
|-----------------------------|--------|
| 1. Burimet e brendshme | _____% |
| 2. Kreditë | _____% |
| 3. Investimet e përbashkëta | _____% |
| 4. Donacionet | _____% |

**STRUKTURA E RAPORTIT (PËRSHKRUES) NGA BISEDA ME
PËRFAQËSUESIN E NDËRMARRJES**
(1-2 faqe për secilën ndërmarrje)

1. Përshkrimi i problemeve themelore për riaktivizimin e ndërmarrjes ose rritjen e vëllimit të punës (studimi për aktivitetin e ndërmarrjes)?
2. A janë të përpiluar plane biznesi?
3. Çfarë mendimi kanë për tatimet dhe doganat, a janë ato stimulative apo paraqiten si pengesë për ushtrimin e veprimtarisë (koment i shkurtër)?
4. Çka mendojnë për privatizimin e ndërmarrjes dhe a kanë patur të interesuar, a egziston klima në ndërmarrje për privatizim?
5. Çfarë mendimi kani për dhënien me qira të ndërmarrjeve shoqërore?
6. Përshkruani ndonjë problem që ju theksoni posaçërisht:

